Deri sa Përgjegjësi për bujqësi dhe zhvillim rural dhe punët ekonomike dhe punë tjera administrative, në Sekretariatit për Bujqësi dhe zhvillim rural të Komunës së Tuzit gjendet në gjendjen e Ushtruesit të Detyrës së Kryeadministratorit.

PËRPUNIMI NORMATIV

Sekretariati në fjalë ka përpunuar dhe drejtuar drejt Kuvendit të Komunës së Tuzit një Vendim nga fushëveprimi i vet të cilat janë edhe miratuar:

- Programi i masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit të bujqësorisë në Komunën e Tuzit për vitin 2024 – Agrobuxheti

Punët dhe detyrat të cilat janë duke u kryer:

Në fazë të hartimit janë:

- Programi i masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit të bujqësorisë në Komunën e Tuzit për vitin 2024 – Agrobuxheti
- Ka përfunduar përgaditja e Programit të këtij Sekretariatit e i cili do të drejtohet Kuvendit të Komunës së Tuzit me qëllim të inkorporimit të këtij programi në Programin e punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit.

PUNËT ADMINISTRATIVE NGA FUSHËVEPRIMI I SEKRETARIATIT

Me kërkesë të palëve janë lëshuar 87 Vërtetime se parashtruesi është Prodhues Bujqësor prej të cilave 72 me qëllim të rregullimit të kompensimit për moshë, 1 me qëllim të regjistrimit në Regjistrin e Sigurimeve, 1 për konkurrim për bursë dhe 13 të tilla për regjistrim në regjistrin e sigurimeve për bujq.

Është realizuar procedura sipas Thirrjes Publike dhe është marrë pjesë në procedurë ipas Programit të masave si më poshtë:

Nr.	MASAT E AGROBUXHETIT
	Bujqësia dhe zhvillimi rural
1	Subvencione për mbështetjen e prodhuesve bujqësor
1.1	Pagesat e drejtëpërdrejta në bazë të sipërfaqes
1.2	Pagesat e drejtëpërdrejta për kokë bagëtie
1.3	Mbështetje zhvillimit të prodhimit të qumështit të tregut
1.4	Mbështetje avancimit të bletarisë
1.5	Mbështetje korrjes së drithërave
1.6	Participimi në pagesat e kontributeve ndaj prodhuesve bujqësor
1.7	Mbështetje programit të mbrojtjes së bimëve
1.8	Mbështetja shfrytëzimit të kullosave malore
2	Shërbimeve të tjera
2.1	Promovimi i prodhimeve bujqësore
2.2	Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi

Është marrë pjesë në miratimin e Vendimit për pagesat mujore ndaj prodhuesve të qumështit. Subvencionet e qumështit janë dhënë për anëtarët e kooperativës sipas një liste që jepet në mënyrë periodike (numri ndryshon çdo muaj) nga ministria kompetente. Është paguar një shumë prej 132,738.6€. Subvencioni është paguar 0.08 €/litër. Sasia e qumështit të grumbulluar për periudhën dhjetor-nëntor është 1.659.233 litra.

Është marrë pjesë në miratimin e Vendimit për Subvencionimin e Prodhimit Bimor për njësi të sipërfaqes, për 254 prodhues bujqësor në vlerë të përgjithshme prej 238,406,60€.

Është marrë pjesë në miratimin e Vendimit për subvencionimin për krerë bagëti. 239 blegtorë kanë marrë mbështetje në vlerë totale prej 80,000€.

Është marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për subvencionimin për përmirësimin e bletarisë. Mbështetja iu dha 54 bletarëve në vlerë prej 40,000€.

Është marrë pjesë në miratimin e Vendimit për subvencionim për pagesën e kontributeve të sigurimit pensional për 11 prodhues bujqësor në vlerë prej 1,602,48€.

Është marrë pjesë në vendimin për subvencionimin për mbrojtjen e bimëve. Mbështetja iu dha 16 prodhuesve bujqësorë në vlerë prej 8,535,74€.

Është marrë pjesë në vendimin për subvencionim për shfrytëzimin e kullotave malore për 11 aplikues në vlerë të përgjithshme prej 2,505€.

Është marrë pjesë në miratimin e Vendimit për Subvencionimin për Mbështetjen e Korrijës së Drithërave. Mbështetja për korrijën e drithërave u është dhënë 27 prodhuesve, në vlerën totale mbështetjes prej, 3,570.00€.

Është marrë pjesë në spërkatjen e mushkonjave dhe trajtimin e brejtësve si dhe dezinfektimin e objektit të komunës së Tuzit. Janë organizuar 4 trajtime për të gjithë territorin e komunës, si dhe disa trajtime shtesë sipas nevojës. Gjatë zbatimit, autoriteti mbikëqyrës monitoroi në mënyrë aktive faktorët ndikues dhe në bazë të tyre organizoi në kohë trajtimet e nevojshme dhe njoftoi bletarët për kohën e trajtimit për të mbrojtur në kohë kolonitë e tyre.

Të gjitha trajtimet janë kryer me cilësi të lartë, në përputhje me rregulloret në fuqi dhe gjatë një periudhe të përshtatshme për trajtimet e kontraktuara.

Janë mbajtur takime me prodhuesit bujqësorë nga zona e komunës së Tuzit lidhur me kostot e tyre të prodhimit dhe mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve.

Kemi përgjigjur shkresës së Drejtorisë së Pagesave në lidhje me parandalimin e financimit të dyfishtë të investimeve që janë objekt i mbështetjes nga programet IPARD.

Marrëdhëniet e punës -

Ky sekretariat ka të punësuar gjashtë punonjës, njëri prej të cilëve është në rolin e Kryeadministratorit.

Është kryer procedura për vlerësimin e nëpunësve civilë.

Janë sjellë vendime për pushimet vjetore për të gjithë punëtorët, vendimet për vendet e punës, si dhe vendimet mbi të ardhurat.

Programi i punës-

Është hartuar Programi i Punës së Sekretariatit për vitin 2025, i cili është miratuar nga Kryetari i Komunës së Tuzit, në bazë të mendimit të marrë më parë nga Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale dhe Kryeadministratori.

Raporti i Punës-

Është përgatitur raporti për punën e sekretariatit për vitin 2023, i cili është miratuar nga kryetari i komunës së Tuzit.

Raport për procedurë administrative –

Raporti për procedurën administrative në kuadër të këtij sekretariati është përpunuar dhe i është dërguar Kryeadministratorit për inkorporim në Raportin për Procedurën Administrative të atij organi.

Ekonomsko računovodstveni poslovi –

Detyrat ekonomike dhe të kontabilitetit në kuadër të këtij sekretariati, të cilat kanë të bëjnë me subvencionet, ndihmat, rekuizimet, pagat dhe detyra të tjera, janë realizuar në bashkëpunim me sekretariatet kompetente.

Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës –

Në vitin 2024 nuk kishte vende të lira të parashikuara në Rregullore.

Plani kadrovik -

Është hartuar plani kadrovik i sekretariatit, janë dorëzuar listat e pagave dhe janë kryer procedura të tjera administrative për vitin 2024, si dhe janë mbajtur kontaktet me organet dhe institucionet shtetërore kompetente në kuadër të fushëveprimit të sekretariatit.

Qasja e lirë në informacion –

Në fushën e qasjes së lirë në informacion, është miratuar një Udhëzues për Qasje të Lirë në Informacion, si dhe një zyrtar i caktuar përgjegjës për marrjen e vendimeve për të. Sipas këtij vendimi qasja në informacion është falas.

Ndihmë për qytetarët -

Është procesuar dokumentacioni dhe janë plotësuar formularët e nevojshëm për qytetarët që kanë dorëzuar faturat për subvencione nga ministria kompetente.

Promovimi i bujqësisë -

Panairi bujqësor është organizuar në Triesh, ku Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ishte një nga organizatorët.

Mori pjesë në ekspozitat e produkteve bujqësore nga komuna e Tuzit në Big Fashion.

Aktivitetet të tjera -

Është realizuar Diskutimi Publik mbi Agrobuxhetin

Janë dhënë udhëzime profesionale qytetarëve nga kjo komunë që merren me prodhimtarinë bujqësore

Është marrë pjesë në seminare, tryeza të rrumbullakëta, trajnime online etj.

Raporti financiar i Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural për periudhën 01.01.2024 do 31.12.2024

I.	PAGAT, KONTRIBUTET DHE SHPENZIME TË TJERA	79 528,44 €
II.	PROD HIMTARIA BUJQËSORE DHE ZHVILLIMI RURAL	507 358.46
	Pagesat e drejtëpërdrejta në bazë të sipërfaqes	238 406,61€
	Pagesat e drejtëpërdrejta për kokë bagëtie	80 000,00€
	Mbështetja ndaj zhvillimit të prodhimtarisë së qumështit për treg	123 738,60€
	Mbështetje për avancimin e bletarisë	40 000,00€
	Mbështetje mbjdhjes së drithërave të imëta	3 570,00€
	Participimi në pagesën e kontributeve ndaj prodhuesve bujqësor	1 602,48€
	Mbështetje programit përmbrojtjen e bimëve	8 535,74€
	Mbështetja shfrytëzimit të kullosave malore	2 505,00€
III.	Shërbime të tjera	12 281.33
	SHPENZIMET TË REALIZUARA NË TOTAL (I+II+III)	599 168.23 €

4. SEKRETARIATI PËR URBANIZËM

Baza ligjore për dorëzimin e raportit vjetor për punën e Sekretariatit për Urbanizëm të Komunës së Tuzit gjendet në nenin 22 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së

administratës lokale të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare i Malit të Zi – Dispozitat Komunale” Nr. 022/23, 024/23, 29/24, 032/24) e cila përcakton detyrimin që organi i administratës lokale, sipas nevojës, dhe së paku një herë në vit, të paraqesë raport pranë Kryetarit të Komunës për punën dhe gjendjen në fushën për të cilën është themeluar.

Raporti është përgatitur në pajtim me nenin 12 paragrafin 1 të Udhëzimit për përgatitjen e programit vjetor të punës dhe raportin për punën dhe kryerjen e funksioneve të vetëqeverisjes lokale me numër 01-041/24-663/1 të datës 01.02.2024., me të cilin parashikohet që eprori i organit administrativ, ose drejtuesi i shërbimit të posaçëm dhe profesional, t’i paraqesë kryetarit të komunës raport për punën e vitit të kaluar, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës.

Raporti për punën e Sekretariatit për Urbanizëm të Komunës së Tuzit për vitin 2024 paraqet një pasqyrë të përgjithshme të punëve më të rëndësishme të realizuara në periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2024.

FUNKSIONI NORMATIV

Në periudhën raportuese, Sekretariati ka përgatitur aktet e mëposhtme:

- Programi i Punës së Sekretariatit Urbanizëm për vitin 2025
- Raporti Vjetor 2023
- Raport mbi aktivitetet administrative të Sekretariatit për vitin 2023
- Raporti për gjendjen e planifikimit hapësinor të Komunës së Tuzit për vitin 2024, numër: 07-332/24-8797/1 datë 31.12.2024.
- Rregullore mbi ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Sekretariatit për Urbanizëm të Komunës së Tuzit, me numër 07-100/24-184/5 të datës 18.01.2024.
- Rregullore mbi ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e punëve të Sekretariatit, me numër 07-100/24-4890/5, datë 22.07.2024.
- Udhëzues për Qasje të Lirë në Informacion të këtij organi, numër: 07-070/24-657/1 datë 31.01.2024.

FUNKSIONI ADMINISTRATIV

Sekretariati për Urbanizëm kryen punët administrative të përcaktuara në nenin 7 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale” nr. 022/23 dhe 024/23.) si dhe rregulloret në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të hapësirës, mbrojtjes së ambientit dhe trafikut.

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Sekretariatit për Planifikim Urbanistik të Komunës së Tuzit, me numër 07-100/23-3127/5 të datës 15.05.2024. dhe Rregulloren për Ndryshimet dhe Plotësimet Nr. 07-100/24-184/5 datë 18.01.2024. si dhe Rregulloren mbi Ndryshimet dhe Plotësimet Nr. 07-100/24-4890/5 datë 22.07.2024., Sekretariati për Urbanizëm është organizuar si njësi e vetme organizative.

Në Sekretariatin për Urbanizëm të Komunës së Tuzit gjatë vitit 2024 janë pranuar gjithsej 117 kërkesa për zgjidhje në procedurën administrative të shkallës së parë, prej të cilave 101 janë zgjidhur dhe 16 lëndë janë bartur për zgjidhje në vitin aktual.

Nga 101 lëndë të zgjidhura, numri i kërkesave të pranuar është 98, numri i kërkesave të refuzuara është 1, ndërsa numri i procedurave të pezulluara është 2.

Një ankesë është parashtruar gjatë periudhës raportuese.

Sipas detyrës zyrtare, ky Sekretariat ka nxjerrë 28 vendime në fushën e marrëdhënieve materiale të nëpunësve dhe zyrtarëve vendorë (1 vendim për vlerësimin e punës provuese, 4 vendime për vlerësimin e performancës, 1 vendim për vendosjen e marrëdhënies së punës me afat të pacaktuar, 4

vendime për caktim detyre, 5 vendime mbi të ardhurat, 8 vendime për shfrytëzimin e pushimit vjetor, 1 vendim për rimbursimit e shpenzimeve të udhëtimit për punë dhe 4 vendime për pjesën e ndryshueshme të pagës).

Sa i përket kërkesave të tjera në juridiksionin e Sekretariatit që nuk hyjnë në procedurë administrative, janë paraqitur gjithsej 207 kërkesa, si më poshtë:

Për dhënien e kushteve urbanistike dhe teknike janë paraqitur 29 kërkesa (7 kërkesa për objekte të përhershme, 22 për të përkohshme).

Për objektet e përhershme janë lëshuar 5 Kushte Urbanistike Teknike dhe janë bërë 2 deklarime se nuk është e mundur të lëshohen kushte Urbanistike Teknike. Për objekte të përkohshme janë lëshuar 18 Kushtet Urbanistike Teknike, ndërsa në vitin aktual janë bartur 4 kërkesa.

Në të njëjtën periudhë janë dorëzuar 14 kërkesa për lëshimin e ekstrakteve nga dokumentacioni planor dhe 4 kërkesa për dhënie të mendimeve nga aspekti i dokumentacionit të planifikimit hapësinor dhe po aq janë lëshuar.

Me kërkesë të palëve janë lëshuar 15 vërtetime për faktet për të cilat Sekretariati mban evidencë zyrtare.

Gjithashtu, me kërkesë të palëve, ky Sekretariat ka nxjerrë gjithsej 59 opinione lidhur me vlerësimet e ndikimit në mjedisin jetësor. Në periudhën raportuese, ky organ ka përgatitur gjithsej 47 Projektvendime për përcaktimin e lokacionit me elemente urbanistike dhe kushte teknike për ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm.

Në këtë Sekretariat janë dorëzuar 20 kërkesa për vendosjen e ngadalësuesve të shpejtësisë dhe 14 kërkesa për asfaltimin dhe modernizimin e rrugëve dhe riparimin e gropave, ndërsa 3 kërkesa për vendosjen e pasqyrave të komunikacionit, 1 kërkesë për rikonstrukcionin e një urë dhe 1 kërkesë për vendosjen e mobileve urbane, të cilat janë bartur në vitin aktual për mungesë burimesh financiare.

PLANIFIKIMI DHE RREGULLIMI HAPËSINOR

Planifikimi hapësinor konsiderohet të jetë monitorimi i gjendjes së hapësirës, hartimi dhe miratimi i dokumenteve planifikuese dhe zbatimi i dokumenteve planifikuese.

Dokumentet planifikuese janë Plani Hapësinor i Malit të Zi dhe Plani Rregullues i Përgjithshëm i Malit të Zi. Ministria është përgjegjëse për përgatitjen dhe miratimin e dokumentit planor. Planet e lartpërmendura miratohen nga Parlamenti i Malit të Zi.

Zona e Komunës së Tuzit është planifikuar me Planin Hapësinor Urban të Kryeqytetit, dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit vendor për nga hierarkia.

Të gjitha dokumentet e tjera lokale të planifikimit janë plane të nivelit më të ulët (PDU PU dhe SLL), ato përgatiten në përputhje me udhëzimet nga PHU dhe detajojnë kushtet për ndërtimin dhe rregullimin e ndërhyrjeve individuale në hapësirë, veçanërisht në lidhje me qëllimin, pozicionin, madhësinë, udhëzimet e përgjithshme, projektimin dhe mënyrat e lidhjes me infrastrukturën publike, komunale dhe të tjera, si dhe të përcaktojnë masat për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe vlerave të tjera të përcaktuara me ligj.

Plani Hapësinor i Kryeqytetit Podgorica është miratuar në vitin 2014 dhe është i vlefshëm deri në vitin 2025 ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale" Nr. 6/2014), Marrëveshja Nr. 01-031/10-3604 datë 03.06.2010., ose deri në miratimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm të Malit të Zi.

Baza për përgatitjen e PHU, së Kryeqytetit Podgorica janë dokumentet planifikuese dhe strategjitë e miratuara në nivel shtetëror, rajonal dhe kryeqyteti, si dhe në nivel të sektorëve individualë dhe studimet e kryera për nevojat e këtij dokumenti: një studim bazë mjedisor, një studim bazë të politikës së truallit, një strategji zhvillimi socio-ekonomik dhe studim bazë të trafikut, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të këtij plani.

Ky plan digjitalizon hartat grafike për herë të parë, duke marrë në këtë mënyrë të dhënat e sipërfaqes.

Termi GUR do të përdoret për gjendjen e planifikuar. Pjesa grafike e Draftit PUD ka dy atlase. Atlasi 1 përmban gjithsej 31 harta në shkallët 1:50,000, 1:25,000, 1:10,000 dhe 1:5,000. Atlasi 2 përmban gjithsej 13 harta në shkallët 1:200,000, 1:50,000, 1:25,000 dhe 1:10,000.

Dokumentacioni ekzistues planor i miratuar para Planit Urbanistik të Kryeqytetit, i cili është miratuar në vitin 2014 dhe ka të bëjë me territorin e Komunës së Tuzit, përfshin:

- SLL “TREGU - Pijaca” – parcela kadastrale 2315/4 në Tuz (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat Komunale” nr. 37/11), shtrihet në sipërfaqe prej 26.14 ha.

- SLL “Tuz – pjesë e zonës planifikuese 19” (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale” Nr. 24/13), shtrihet në një sipërfaqe prej 19.1 ha.

Pas miratimit të Planit Hapësinor Urbanistik të Kryeqytetit Podgorica në vitin 2014, është vendosur regjimi i planifikimit hapësinor brenda kufijve të Zgjidhjes Gjenerale Urbanistike të Tuzit. Planet që u miratuan janë:

- Plani i detajuar urban “Mali i Shipshanikut” (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Dispozitat komunale” nr. 27/15) shtrihet në një sipërfaqe prej 16.45 ha.

- Plani i detajuar urban “Dheu i zi” (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale” Nr. 47/16) mbulon një sipërfaqe prej 155.92h.

Gjatë vitit 2024, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Urbanizmit dhe Pronës Shtetërore ka miratuar Projekt-amandamentet e Planit Hapësinor Urbanistik të Kryeqytetit Podgorica.

Ministria, në bashkëpunim me Komunën e Tuzit, më 06.12.2024 organizoi prezantimin publik të Projekt-Ndryshimeve në Planin Hapësinor Urbanistik të Kryeqytetit Podgorica nga ora 10:00 deri në ora 12:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Tuzit, Komuna e Tuzit. dhe

Ky organ në periudhën raportuese ka dorëzuar një projekt-mendim në Ministri për ndryshimet në dokumentin e sipërpërmendur të planifikimit.

Kushtet Urbanistike – Teknike

Sipas dispozitave të Ligjit për planifikim hapësinor dhe ndërtim të objekteve (“Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 64/17, 44/18 19/11 dhe 63/18 dhe 82/20), punët e lëshimit të kushteve urbane dhe teknike janë në kompetencë të Ministrisë përkatëse të Planifikimit Hapësinor, Urbanizmit dhe pronës shtetërore. Rregullorja për kalimin e një pjese të punës Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, Urbanizmit dhe Pronës Shtetërore, Njësi të Vetëqeverisjes Lokale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi, nr. 012/24, 24/073, 128/24) i ka besuar organeve të administratës lokale detyrën e nxjerrjes së kushteve urbanistike dhe teknike.

Në periudhën raportuese janë dorëzuar gjithsej 7 kërkesa për kushte urbanistike-teknike të lëshuara, janë lëshuar 5 kushte urbanistike dhe janë bërë 2 deklarime se nuk ka mundur të lëshohen kushte urbanistiko-teknike.

Gjithashtu, në pajtim me Vendimin për vendosjen ose ndërtimin dhe heqjen e objekteve ndihmëse (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, nr. 048/20, datë 31.12.2020), këtij Sekretariati i është dorëzuar 1 kërkesë për lëshimin e kushteve për instalimin ose ndërtimin e një objekti ndihmës dhe është pezulluar për shkak të tërheqjes së kërkesës nga pala.

Në kuadër të procedurës për dhënien e kushteve urbanistike dhe teknike (objekte të përhershme dhe të përkohshme), në Administratën e Pasurive të Paluajtshme - Dega Podgoricë janë dërguar shkresa për lëshimin e pronave të paluajtshme dhe të pronësisë, kopje të planeve dhe koordinatave, si dhe letra drejtuar doo/shpk “Vodovod i kanalizacija / Ujësjellës Kanalizime” Ministrisë së Transportit, Drejtorisë për Transport dhe Drejtorisë për Ujëra, për paraqitjen e kushteve të veçanta teknike.

Objektet e përkohshme

Në periudhën raportuese, bazuar në Programin e Objekteve të Përkohshme për Territorin e Komunës së Tuzit për periudhën nga maji 2020 deri në maj 2025 ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale", nr. 020/20), të përfshira në nenin 116 të Ligjit për Planifikimin e Hapësirës dhe Ndërtimit të objekteve. Programi i lartpërmendur është ndryshuar dy herë, me Vendim për miratimin e ndryshimeve në Programin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale" nr. 046/21) dhe nga 31.12. 2020., dhe Vendimin për miratimin e ndryshimeve në Programin e Objekteve të Përkohshme në territorin e Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale" nr. 037/24).

Dispozitat e nenit 74 të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim të Objekteve, ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 64/17, 44/18, 63/18, 11/19, 82/ 20 dhe 086/22) .

Të dhënat për numrin dhe llojin e objekteve të përkohshme për të cilat janë lëshuar kushtet urbanistike dhe teknike në periudhën 01.01.-31.12.2024. Salla e montimit dhe hangar – Janë lëshuar 4 kushte urbanistike dhe teknike, për stacionin bazë 1, për tarracën e hotelierisë 5, për objekt tregtar dhe shërbim 1, pushimore 2, billboard 2, objekt hotelierie i përkohshëm 3, ndërsa janë bartur 4 lëndë deri në vitin aktual.

Gjithashtu, me kërkesë të palëve, ky Sekretariat ka nxjerrë 7 Vendime për vendosjen e objekteve të përkohshme si stendat e luleve dhe stendat e ekspozimit të librave.

Tarifa për pajisjen komunale të tokës ndërtimore dhe tarifat për sanimin (rehabilitimin) urban

Në periudhën raportuese, ky Sekretariat, në përputhje me Vendimin për tarifat e sanimit urban ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 48/20), ka nxjerrë 5 Vendime për përcaktimin e tarifës së sanimit urban për legalizimin e objekteve pa leje mbi përllogaritjet e kryera më parë dhe 1 vendim që përcakton se aplikanti nuk i nënshtrohet detyrimit për të paguar tarifat e sanimit urban. Sekretariati për Planifikim Urban i Komunës së Tuzit ka lidhur 5 kontrata për kompensim për sanimin urban.

Në bazë të Vendimit për tarifën për pajisjen komunale të truallit ndërtimor ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 48/20), janë lëshuar 4 vendime për caktimin e tarifës për pajisjen komunale të truallit ndërtimor, ndërsa në bazë të Vendimit të lartpërmendur, dhe nenit 239 të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim të Objekteve, janë lëshuar 7 vendime me të cilat përcaktohet se investitori nuk i nënshtrohet detyrimit për pagesën e tarifës për pajisjen komunale të truallit ndërtimor.

Në periudhën prej 01.01.2024. deri më 31.12.2024., taksa e mbledhur për pajisjen komunale të truallit ndërtimor është 101,224,47€, ndërsa kompensimi i paguar për sanimin urban të legalizimit të objekteve pa leje është 16,282,67€.

Lejet e ndërtimit dhe lejet e përdorimit nën kompetencën e Sekretariatit

Në periudhën raportuese, ky Sekretariat ka nxjerrë 8 vendime për miratimin e ndërtimit të objekteve lokale me interes të përgjithshëm, 4 vendime për përcaktimin e personit që kryen kontrollin teknik të objektit dhe 4 vendime për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm, të gjitha në përputhje me Vendimin për ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 33/19, 34/20).

Në kuadër të procedurës së dhënies së lejeve për ndërtim, janë dërguar shkresa në shpk Ujësjellësi dhe kanalizimi - Tuz, administratës për komunikacion, Ministrisë së Punëve të Brendshme – Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, për dhënien e pëlqimeve në dokumentacionin projektues.

Vendim për përcaktimin e lokacionit me elemente urbanistike dhe kushte teknike

Gjithashtu, në periudhën raportuese ky organ ka përgatitur gjithsej 47 Projektvendime për përcaktimin e lokacionit me elemente të kushteve urbanistike dhe teknike.

Procedura për legalizimin e ndërtimeve pa leje

Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 64/17, 44/17, 63/17 dhe 11/19), i cili ka hyrë në fuqi më 14 tetor 2017, ka krijuar kushtet ligjore për zbatimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor dhe ndërtim të objekteve, i cili ka hyrë në fuqi më 14 gusht 2020, sërish parasheh mundësinë e paraqitjes së kërkesës për legalizim pa afat. Neni 235a, paragrafi 1 i Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 64/17, 44/17, 63/17, 19/11, 82/20 86/22) përcakton se për objektet e regjistruara në ortofoto nga neni 155 i këtij ligji, në pajtim me këtë ligj, në organin kompetent të qeverisjes vendore mund të paraqitet kërkesa për legalizim. Ky organ është ende në procedim të një numri të madh procedurash për legalizimin e strukturave pa leje për të cilat janë paraqitur kërkesa në vitin 2018, ndërkohë që kërkesa të reja janë duke u paraqitur që nga viti 2020.

Në periudhën raportuese janë paraqitur gjithsej 22 kërkesa për legalizim të objekteve pa leje. Ky organ ka përcjellë 13 ftesa për plotësimin e kërkesave për legalizimin e objekteve pa leje. Numri i vendimeve të lëshuara për miratimin e legalizimit të objekteve pa leje është 6, ndërsa në 1 rast procedura është pezulluar për shkak të tërheqjes së parashtruesit.

Lëshimi i Certifikatave nga Dokumentacioni Planifikues

Ky Sekretariat është përgjegjës për, në pajtim me nenet 11a dhe 220a të Ligjit për planifikim hapësinor dhe ndërtimin e objekteve (“fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 64/17, 44/17, 63/17, 19/11, 82/ 20 86/22) i cili përcakton se deri në miratimin e planit të përgjithshëm rregullues të Malit të Zi, organi i administrates lokale do të lëshojë një certifikatë nga dokumenti planor për zonën brenda kufijve të dokumentit planor lokal.

Prandaj, gjatë vitit 2024 janë lëshuar 14 ekstrakte nga dokumenti planor dhe 4 mendime apo deklarata nga aspekti i dokumentacionit të planifikimit hapësinor.

KOMUNIKACIONI

Në përputhje me Ligjin për Rrugët (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi” nr. 082/20, 140/22) dhe Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor (“Fleta zyrtare e Malit të Zi” nr. 033/12, 058/14, 014/17, 066/ 19) Për dokumentacionin teknik të përgatitur janë lëshuar 9 leje komunikacioni,

Në bazë të Rregullores për shënimin e hapësirave të parkimit të automjeteve për personat me aftësi të kufizuara dhe paraqitjen e shenjave të aksesueshmërisë që shënojnë automjetet e personave me aftësi të kufizuara (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 079/16) dhe Vendimit për parkingjet publike të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 46/19) në periudhën raportuese janë paraqitur 11 kërkesa për lëshimin e shenjës së aksesueshmërisë me shënimin e automjetit të personit me aftësi të kufizuara. Kështu, janë dhënë 10 vendime për dhënien e shenjës së aksesueshmërisë, ndërsa një rast është bartur në vitin 2025.

Transporti publik i pasagjerëve urban dhe periferik kryhet nga shoqëria e transportit “Komunalno/Komunale” sh.pk në bazë të licencës së lëshuar për kryerjen e transportit në transportin e planifikuar të pasagjerëve urban dhe periferik, si dhe 2 certifikata licenca të lëshuara nga ky Sekretariat.

Në bazë të dispozitave të nenit 122 të Ligjit për transportin rrugor (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 71/17), në periudhën raportuese janë dorëzuar 8 kërkesa për dhënien e lejeve për kryerjen e transportit të mallrave për nevoja vetjake ky organ, të cilat janë edhe lëshuar.

Në pajtim me Vendimin për rrugë lokale dhe të pa kategorizuara (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 33/19), në periudhën raportuese janë dorëzuar gjithsej 3 kërkesa për gjurmim të truallit publik dhe sipërfaqeve rrugore, për çka është dhënë edhe përgjigja pozitive, pra Vendimi.

Në bazë të Vendimit për Rendin Komunal (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 033/19, datë 14.08.2019), ky Sekretariat, me kërkesë të palës, ka lëshuar 1 Vendim me të cilin aprovohet zënia e hapësirës publike.

Në këtë Sekretariat janë dorëzuar 20 kërkesa për vendosjen e ngadalësuesve të shpejtësisë, asfaltimin dhe modernizimin e rrugëve dhe 14 kërkesa për riparimin e gropave në rrugë, ndërsa 3 kërkesa për vendosjen e pasqyrave të komunikacionit, 1 kërkesë për rikonstruksionin e një ure dhe 1 kërkesë për montimin e mobileve urbane.

MJEDISI JETËSOR

Bazuar në Ligjin mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 075/18), gjatë periudhës raportuese janë dorëzuar 10 kërkesa për marrjen e vendimit për nevojën e përgatitjes së studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Për 8 procedura janë marrë vendime se nuk është kërkuar studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, ndërsa për 2 raste është marrë vendim që është kërkuar studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Gjithashtu janë dorëzuar 2 kërkesa për miratim të Studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nga të cilat njëra procedurë ka rezultuar me Vendim me të cilin refuzohet kërkesa për miratim të Studimit, ndërsa procedura tjetër është pezulluar për shkak të tërheqjes së kërkesës nga pala.

Bazuar në Ligjin mbi Ujërat (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 27/07 dhe “Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 73/10, 32/11, 47/11, 48/15, në këtë Sekretariat është dorëzuar një kërkesë për lëshimin e kushteve ujore për të cilin ky organ ka lëshuar Vendim mbi miratimin e kushteve ujore. Gjithashtu, ky Sekretariat ka lëshuar gjithsej 59 vlerësime lidhur me ndikimin në mjedis, si dhe 1 Pëlqim për Regjistrin e grumbulluesve.

KAPACITETI ORGANIZATIV DHE I PERSONELIT PËR TË KRYERË FUNKSIONIN E SEKRETARIATIT

Në Sekretariat për Urbanizëm të Komunës së Tuzit, përveç Sekretarit, gjatë periudhës raportuese janë punësuar edhe 8 punëtorë kurse 1 punonjës është i penguar përkohësisht për punë gjatë vitit 2024. Gjithashtu, 1 punonjës ka filluar punë në nëntor 2024.

KONKLUDIMI DHE PROPOZIMI I MASAVE

Vazhdimi i bashkëpunimit me drejtues dhe kolegë nga organet e tjera të qeverisjes lokale dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna, si dhe bashkëpunimi me Ministrinë përkatëse, me qëllim të përmirësimit të punës së Sekretariatit, të mundësohet zhvillimi profesional i punonjësve përmes ndjekjes së kurseve të trajnimit lidhur me zbatimin e Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe zbatimin e Ligjit lidhur me fushën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit dhe ndërtimit të objekteve, si dhe në fushën e komunikacionit dhe mjedisit.

5. SEKRETARIATI PËR ZHVILLIM DHE PROJEKTE

Raporti është përgatitur në përputhje me Udhëzimin për përgatitjen e programit vjetor të punës dhe Raportin për punën dhe zbatimin e funksionit të vetëqeverisjes lokale, të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 40/19).

Në periudhën raportuese, Sekretariati, në përputhje me rregulloret dhe aktet nënligjore në fuqi, ka kryer punë që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve, rregulloreve tjera, akteve të miratuara nga

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Tuzit, ka zgjidhur rastet administrative dhe ka kryer punë profesionale dhe të tjera në kuadër të fushëveprimit të përcaktuar të punës.

Gjatë kryerjes së detyrave në kompetencat e veta, Sekretariati bashkëpunoi me organet dhe shërbimet e Komunës së Tuzit, shoqëritë afrieste të themeluara nga komuna, në varësi të natyrës së detyrave, dhe me organet e komunave të tjera në Mal të Zi, organet shtetërore, institucionet, organizatat joqeveritare dhe qytetarët, të gjitha në përputhje me Statutin, të drejtat dhe detyrat e tjera pozitive të rregulloreve të komunës së Tuzit.

REALIZIMI I FUNKSIONIT TË ORGANIT

Aktivitete nga fushëveprimi i sekretariatit

Sekretariati në periudhën raportuese ka organizua dhe ka realizuar:

- Në bashkëpunim me Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale, punëtori për shkrimin e projekteve për nxënës të shkollave të mesme në komunën e Tuzit.
- Pjesëmarrje në trajnime, seminare, punëtori, konferenca, takime të shumta, duke përfshirë:
- Pjesëmarrje në trajnime për zbatimin e Programit të Përgjithshëm për Formimin Profesional dhe Formimin e Avancuar të Nëpunësve Civil Vendorë dhe Punonjësve, për periudhën 2024. Uçestvovanje na raznim obukama/seminarima/treninzima organizovanim od strane državnih organa i drugih institucija.
- Inicimi i nënshkrimit të memorandumit bashkëpunues ndërmjet Komunës së Tuzit dhe ADP ZID për hartimin e një plani veprimi për sipërmarrje sociale.
- Ka filluar procedura për zhvillimin e softuerit për fushën e sipërmarrjes, hoteljerisë dhe turizmit.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi në kuadër të projektit M4EU si dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit M4EU
- Pjesëmarrja në trajnime për zbatimin e projektit në kuadër të programit Kroaci-Bosnjë dhe Hercegovinë-Mali i Zi
- Është organizuar dhe zbatuar debat publik lidhur me Projektvendimin për ndryshimin e vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për përkrahjen e ndërmarrësisë së grave.

Puna për arritjen e kriterëve në kuadër të Programit të Çertifikimit të Qyteteve dhe Komunave me veprimtari të kënaqshme në Evropën Juglindore BFC SEE Edition IV, ku:

- U krijua Këshilli Ekonomik si organ këshillues i Kryetarit nga përfaqësues të ekonomisë. U zhvilluan tre takime.
- U krijua faqja investintuzi.me me të gjitha informacionet e nevojshme për biznesmenët brenda Komunës dhe Malit të Zi, si dhe për investitorët jashtë vendit.
- Është hartuar plani për zhvillimin e infrastrukturës së Komunës së Tuzit, i cili është miratuar në Kuvendin e Komunës së Tuzit, dhjetor 2024, në bashkëpunim me Sekretariatit për Planifikim Urban.
- Raporti për zbatimin e Planit Strategjik të Komunës së Tuzit është përgatitur dhe miratuar në Kuvendin e Komunës së Tuzit, mars 2024, në bashkëpunim me të gjitha sekretariatet.
- Është realizuar hulumtimi i parë për mjedisin e biznesit dhe nevojat për personel të subjekteve afariste në territorin e komunës së Tuzit.
- Takime të shumta janë zhvilluar me përfaqësues të ekonomisë, investitorë potencialë, Agjencinë e Investimeve etj., në bashkëpunim me Shërbimin e kryetarit.

- Raportimi i rregullt tek donatorët dhe përcjellja e zbatimit të projekteve të zhvilluara nga faqja 6 deri në faqen 9.

FUNKSIONI NORMATIV

Punët normative – ligjore

Në periudhën raportuese janë hartuar dhe janë sjellur aktet si më poshtë:

- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Sekretariatit për Zhvillim dhe Projekte Nr. 6367/5 datë 20.09.2024.;
- Raporti Vjetor 2023
- Programi i punës për vitin 2025
- Udhëzues për qasje të lirë në informacion të Sekretariatit për vitin 2024
- Themelimi dhe aktet e tjera për shoqëritë e themeluara nga komuna, përkatësisht: “Komunalno-Komunale” sh.p.k Tuz, “Pijace-Tregu” sh.p.k.
- Mendime dhe Pëlqime për programet e punës të subjekteve afariste të themeluara nga komuna dhe përpunimi i tyre me dokumente përcjellëse nga Shërbimi i Kryetarit dhe Shërbimi i Kryetarit të Kuvendit.
- Vendim mbi ndryshimet në Vendimin mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për përkrahjen e ndërmarrësisë së grave.

Treguesit e punëve të cilat janë kryer gjatë periudhës:

- Futja e të dhënave dhe ndryshimeve nga raporti tregtar në Regjistrin Tregtar.
- Mbajtja dhe regjistrimi i aplikacioneve në Regjistrin e Zanateve dhe krijimi i bazës së të dhënave.
- Futja e të dhënave të hotelierëve dhe ofruesve të shërbimeve në Regjistrin Qendror të Turizmit në përputhje me rregulloret e miratuara
- Pjesëmarrja në punën e komisioneve, përkatësisht: në punën e Komisionit për Shpërndarjen e Fondeve për Mbështetjen e Ndërmarrësisë së Grave, ku është shpallur Konkursi Publik për shpërndarjen e mjeteve për përkrahjen e sipërmarrjes së grave, ku komuna ka mbështetur financiarisht femrat ndërmarrëse që kanë filluar apo zgjerojnë biznesin e tyre.
- Mbajtja e evidencës së objekteve të banimit
- Publikimi i akteve të përgjithshme dhe akteve të tjera në kompetencë të sekretariatit në përputhje me ligjin dhe
- Çështje të tjera aktuale nga fusha e punës së Sekretariatit.

Sekretariati për Zhvillim dhe Projekte, ose **Sektori i Projekteve**, gjatë vitit të kaluar ka realizuar aktivitete lidhur me aplikimin dhe hartimin e projekteve, si dhe zbatimin e projekteve të miratuara dhe raportimin për to.

Komuna e Tuzit ka filluar realizimin e katër projekteve në programe të ndryshme në të cilat BE-ja është donator, ndërsa një projekt i filluar në vitin 2023 ka vazhduar gjatë gjithë vitit.

Tre projekte janë aplikuar dhe miratuar nga Fondi Eko, ndërsa një projekt është miratuar nga Ambasada Bullgare.

Në kuadër të programit Mali i Zi - Kosovë është aplikuar një projekt në fushën e turizmit, ndërsa në kuadër të programit Itali - Shqipëri - Mali i Zi, apo programi i Adriatikut Jugor janë aplikuar pesë projekte, plus një projekt tjetër në të cilin Komunalno - Komunale sh.p.k., Tuz e regjistruar si partner, dhe Komuna e Tuzit si partner shoqërues. Rezultati për të dy programet pritet në vitin 2025.

Aktivitetet e realizuara në vitin 2024:

1. Projekti NERA – Qasje e re e realizimit të mjedisit jetësor

Në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë, në bashkëpunim me Komunën e Pejës, zbatimi i projektit ka filluar më 1 shkurt 2023. Nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2024 janë realizuar këto aktivitete:

- Është blerë dhe instaluar një peshore kamioni për matjen e mbetjeve të ndara, me qëllim reduktimin e mbetjeve të përziera me të paktën 10% dhe rritjen e riciklimit.
- 20 kontejnerë nëntokë të instaluar në pesë lokacione (katër kontejnerë secila për mbetje plastike, letre/kartoni, metali dhe organike).
- 480 amvisëri kanë pranuar gjashtë pako me thasë për katër lloje të mbeturinave, për të mundësuar ndarjen e mbeturinave nëpër amvisëri, me grumbullim të organizuar nga shoqëria komunale.
- Aplikacioni NERA-T u krijua për të edukuar dhe informuar qytetarët për depozitimin e duhur të mbetjeve dhe vendndodhjet për grumbullimin selektiv të mbetjeve.
- Është krijuar një kantier riciklimi si një vend ku qytetarët mund të sjellin mbetjet e tyre të veçuara, i cili është i dukshëm edhe në aplikacionin NERA-T.
- U krijua një faqe interneti <https://solidwaste-emarket-cbc.com/>, e cila u përditësua gjatë gjithë vitit dhe u mbush me të dhëna përkatëse për bizneset që merren me përzgjedhjen dhe shitjen e mbetjeve, si dhe shembuj të praktikave dhe legjislacionit të mirë në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Në plotësimin e përmbajtjes së faqes së internetit kanë kontribuar edhe partnerët nga Peja.
- Janë nënshkruar 20 memorandume mirëkuptimi ndërmjet Komunës së Tuzit dhe bizneseve të përfshira në menaxhimin e mbeturinave, me qëllim që të dhënat e tyre të përfshihen në ueb faqen e lartpërmendur.
- Janë mbajtur 13 punëtori në gjashtë shkolla në komunën e Tuzit, ku morën pjesë gjithsej 320 fëmijë si pjesë e një fushate sensibilizuese për deponimin e duhur të mbeturinave.
- Janë pastruar dhe gjelbëruar 10 venddepozitime ilegale, me stola prej plastike të ricikluar.
- U organizuan punëtori për punonjësit e Komunales dhe Policisë Komunale, si dhe për fermerët nga të dyja komunat partnere, ku u njohën me konceptin Zero Mbetje, i cili është baza e këtij projekti dhe synimi afatgjatë i të dy komunave, bazuar në planet lokale të veprimit për mbrojtjen e mjedisit.

2. Projekti “Parqet e mençura”

Përmes Ambasadës së Bullgarisë në Mal të Zi, përkatësisht Ndhmës Bullgare për Zhvillim, janë instaluar tre stola diellore në lokacione të ndryshme në Tuz.

3. Projekti ProLIGHTmed

Zgjidhjet progresive për optimizimin e ndriçimit publik në zonën EURO-MED, të financuara përmes Interreg Euro-MED 2021–2027 (thirrja e dytë për projekte tematike), filluan në vitin 2024. Komuna e Tuzit është partneri i vetëm udhëheqës nga vendet e IPA-s dhe vlera e projektit është 2.85 milionë euro. Aktivitetet e realizuara përfshijnë:

- Organizimi i një konference për shtyp për prezantimin e projektit.
- Përgatitja e një analize të gjendjes aktuale të efikasitetit të energjisë dhe emetimeve të CO₂ në ndriçimin publik në Mal të Zi / Komuna e Tuzit.

- Zhvillimi i një skeme financiare për zbatimin e veprimeve të planifikuara për optimizimin e ndriçimit publik.
- Organizimi i dy seminareve mbi strategjitë e qëndrueshme të ndriçimit publik.
- Pjesëmarrje në tri takime të ekipit të projektit në Tuz, Setubal dhe Kastelë.

4. Projekat TOOWASTE

I financuar nga programi Kroaci – Bosnje e Hercegovinë – Mali i Zi, projekti ka filluar më 15. korrik 2024., dhe do të zgjasë deri më 14. janar 2027. Në vitin 2024 u:

- formua një komision ekspertësh, i përbërë nga anëtarë të shoqërive komunale të Tuzit, Mostarit dhe Konavles, si dhe ekipi i projektit, për të shkëmbyer praktikat dhe përvojat në grumbullimin e ndarë të mbeturinave.
- mbajt në Tuz konferenca fillestare, ku partnerët prezantuan projektin para publikut të gjerë.
- hapen rrjete sociale për të promovuar aktivitetet e projektit.
- zbatuan prokurime për një zyrtar të prokurimit publik dhe një fushatë promovuese, ndërkohë që janë duke vazhduar procedurat e tenderit për prokurimin e dy kamionëve, një grajfer dhe një kantier riciklimi.

5. Projekti CROSSMART

Platformë e zhvillimit ndërkufitar për përmirësim të zgjuar dhe të saktë të bujqësisë dhe agrobiznesit

Si pjesë e programit Kroaci - Bosnje dhe Hercegovinë - Mali i Zi, projekti filloi në vitin 2024. Një ekip projekti u formua dhe mori pjesë në konferencën fillestare në Dubrovnik. Aktivitetet konkrete priten në vitin 2025.

6. Projekti CIRCLE WASTE – Danube program

Scaling up eWASTE circular economy in Adria region
Në kuadër të Programit Danube u formua një ekip projekti dhe u mbajtën dy takime online. Zbatimi konkret i aktiviteteve është planifikuar për vitin 2025.

7. Projektet e financuara nga Eko fondi

- Modernizimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve komunale deri në zero mbetje – është blerë një ekskavator për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve të ndërtimit dhe të mëdha, së bashku me trajnimin e punonjësve.
- Përmes ndarjes së mbeturinave nëpër amvisëri – për një Tuz më të bukur dhe më të pastër – janë blerë 1605 kosha 120 litrash, të cilët do të shpërndahen në 535 amvisëri. Çdo familje do të marrë tre kosha (për letër/karton, metal dhe plastikë) me një kod QR që të çon në aplikacionin NERA-T me udhëzime për ndarjen e duhur të mbetjeve.
- Eko-parku për fëmijë, i cili do të përfundojë në vitin 2025.

8. B40 Balkan Cities Network

I krijuar nga Deklarata e Stambollit, rrjeti bashkon qytetet e Ballkanit për të bashkëpunuar për çështjet e ndryshimeve klimatike. Një përfaqësues i Komunës së Tuzit dhe Sekretariatit për Zhvillim dhe Projekte morën pjesë në grupin e punës për migracionin dhe demokracinë në Tiranë.

FUNKSIONI ADMINISTRATIV DHE MBIKËQYRËS

Sektorit i Zhvillimit të Sekretariatit, gjatë periudhës raportuese, i janë dorëzuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Turizmin dhe Hoteljerinë (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 2/18, 4/18, 13/18, 25/19, 67/19, 76/20 dhe 20/21) me të cilin janë paraparë punët dhe kryerja e detyrave

administrative për personat juridik të cilët merren me hoteljeri dhe veprimtari turistike, gjatë afatit raportues janë dorëzuar:

- 44 kërkesa, të cilat kishin të bënin me dhënien e lejeve për kryerjen e llojeve të ndryshme të veprimtarive të hoteljerisë

- Gjatë procedurës administrative për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarive hotelierike në juridiksionin e këtij organi të së drejtës publike, zyrtarët kryen vizita në vend për të përcaktuar nëse kushtet për pajisjet dhe objektet janë plotësuar në përputhje me klauzolat e parashikuara në Rregulloren për llojet, kërkesat minimale teknike dhe kategorizimin e objekteve hotelierike ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr.36/18).

- Gjithashtu, në periudhën raportuese, të gjitha vendimet e vlefshme të nxjerra mbi këtë bazë janë regjistruar në Regjistrin Qendror të Turizmit, i cili është i aksesueshëm për zyrtarët e këtij Sekretariati.

Kur është fjala për fushën e tregtisë të rregulluar me Ligjin për tregtinë e brendshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 49/08, 40/11 dhe 38/19), procedurat administrative nuk zhvillohen në bazë të raporteve të dorëzuara, por ato përpunohen me qëllim të regjistrimit të të dhënave në regjistrin e raporteve tregtare. Mbi këtë bazë, ky organ i së drejtës publike në periudhën raportuese prej 01.01.-31.12.2024., Drejtoria për Çështje të Inspektimit – Departamenti i Inspektimit të Tregut, sipas detyrës zyrtare, ka dorëzuar në juridiksion 82 kërkesa, të cilat përfshijnë regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e aktiviteteve tregtare të subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari tregtare në territorin e komunës sonë.

Të gjitha njoftimet e tregtisë (fillimi, ndryshimi ose çregjistrimi) janë futur në regjistrat elektronikë të mbajtur nga ky autoritet publik ligjor dhe i janë dorëzuar të gjithë subjekteve të interesuara.

Në fushën e zanateve, e cila është gjithashtu në juridiksionin e këtij Sekretariati dhe rregullohet me Ligjin mbi Zejtaret ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 54/09, 64/09 dhe 40/11), në periudhën raportuese janë dorëzuar 16 aplikime, ose ndryshime për të cilat janë lëshuar po aq vërtetime të cilat janë dorëzuar pranë Dhomës së Zejtarisë së Malit të Zi, shërbimeve të interesuaradhe subjekteve afariste. Po kështu, çdo aplikim regjistrohet siç duhet në të dhënat zyrtare të sekretariatit.

Sa i përket zgjatjes së orarit të punës të subjekteve afariste që operojnë dhe kryejnë veprimtari në territorin e komunës sonë në përputhje me dispozitat e Vendimit për Orarin e Punës ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" - Dispozitat komunale, nr. 32/19), në periudhën raportuese nuk ka pasur kërkesa për zgjatje të orarit të punës së subjekteve afariste.

Gjatë periudhës raportuese, pranë këtij organi ligjor publik është dorëzuar një kërkesë për qasje të lirë në informacion, e cila është miratuar pas ankesës në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacion.

Për sa i përket aktiviteteve të banimit, të cilat rregullohen me Vendimin për Organizimin dhe mënyrën e Funksionimit të Administratës Lokale, këtij organi juridik publik nuk i është paraqitur asnjë kërkesë.

Sekretariati për Zhvillim dhe Projekte, në periudhën raportuese, në përputhje me dispozitat e Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit, ka mbikëqyrur punën e subjekteve afariste të themeluara nga komuna e Tuzit, konkretisht Shoqëria "Komunalno-Komunale" Sh.p.k Tuz.

Në vitin 2024 në këtë organ është paraqitur një ankesë, e cila është miratuar brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e vendimit administrativ, veçanërisht nga aspekti i ligjshmërisë dhe shpejtësisë së këtij organi të së drejtës publike, ai mund të vlerësohet si i mirë, dhe nëpërmjet organizimit të punës, përdorimit të evidencës zyrtare, intensifikimit të bashkëpunimit me organet

pjesëmarrëse në procedurë dhe zhvillimit të formave të nevojshme të përshtatura për nevojat e ushtrimit të të drejtave të qytetarëve, është arritur efikasiteti i dukshëm i zbatimit të zgjidhjes administrative.

Është e rëndësishme të theksohet se ky organ juridik publik ka pranuar 354 parashtresa dhe shkresa të ndryshme përmes librit të brendshëm të dorëzimit për vitin raportues.

AFTËSIMI KADROVIK DHE ORGANIZATIV PËR KRYERJEN E FUNKSIONIT TË SEKRETARIATIT

Në përputhje me Rregulloren aktuale për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Sekretariatit për Zhvillim dhe Projekte, në periudhën raportuese, përveç sekretarit, janë angazhuar edhe 4 (katër) punonjëse femra, 3 (tre) punonjës meshkuj dhe 1 (një) zyrtar administrativ dhe teknik, që është numër i pamjaftueshëm për zgjidhje ekonomike dhe efikase të punës të paraparë me Vendimin mbi organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së administratës lokale. Ndërkaq, gjatë periudhës raportuese, një zyrtare dhe një zyrtarë kanë nënshkruar marrëveshje për shkëputje, ndërsa një zyrtarë i tretë është emëruar në pozitë të lartë drejtuese në një organ tjetër të Komunës së Tuzit.

6. SEKRETARIATI PËR PRONË

Baza ligjore për dorëzimin e Raportit për punën e Sekretariatit për Pronë (në tekstin e mëtejme: Sekretariati) gjendet në nenin 116 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, Nr. 024/19, 005/20, 051/22 dhe 055/22) i cili përcakton që organet e administratës lokale të dorëzojnë raportin për punën e tyre, kryetarit të komunës deri në fund të shkurtit të vitit aktual për vitin paraprak dhe neni 22 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së pushtetit lokal të komunës së Tuzit (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi – Rregulloret komunale”, nr. 22/23, 24/23, 29/24 dhe 32/24) i cili përcakton se organet e administratës lokale sipas nevojës, dhe të paktën një herë në vit t’i paraqesin kryetarit të komunës një raport për punën dhe gjendjen në fushën për të cilën janë krijuar në përputhje me udhëzimin e posaçëm të kryetarit, pasi të kenë marrë një mendim paraprak nga kryeadministratori.

Raporti është në përputhje me nenin 12 të Udhëzimit për përgatitjen e Programit Vjetor të Punës dhe Raportit për punë dhe kryerjen e funksionit të vetëqeverisjes lokale, me numër: 01-041/24-663/1, datë 01.02.2024.

REALIZIMI I FUNKSIONIT TË SEKRETARIATIT

Punët dhe detyrat të cilat i ka kryer Sekretariati në periudhën e dhënë:

1. Normative,
2. Pronësore – Juridike
3. Përfaqësimit
4. Administrative

PUNËT NORMATIVE

Funksioni normativ i Sekretariatit u reflektua në zhvillimin e:

- Propozimit të Vendimit për ndryshimin e Vendimit mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësimin e plotë të pronës së paluajtshme për shkak të rindërtimit të rrugës Podgoricë - Tuz nga ura e Zharnicës në lumin Cem deri në kthesën për Shipshanik;

- Propozimit të Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për themelimin e servitutit sendor në kohë të pacaktuar pa kompensim në një pjesë të parcelës kadastrale me numër 2315/1, të regjistruar në listën e pronësisë numër 1991 të KK të Tuzit;

- Propozimit të Vendimit për dhënien e automjeteve në përdorim të përhershëm pa kompensim për “Komunalno/Komunale” sh.p.k. Tuz;

- Propozimit të Vendimit për kalimin e dy autobusëve për transport publik në përdorim të përhershëm pa kompensim të “Komunalno - Komunale” Tuz;

- Udhëzuesit për qasje të lirë në informacion në menaxhim nga Sekretariati për Pronën.

PUNËT PRONËSORE – JURIDIKE

Gjatë vitit 2024 janë lidhur gjithsej 15 kontrata/ anekse kontratash për qiranë e tokës me qëllim instalimin e strukturave të përkohshme parafabrikate (TË KARAKTERIT MONTUES);

Janë përgatitur dhe lidhur dy kontrata për vendosjen e servitutit aktual në pjesë të parcelave kadastrale.

Janë përgatitur 20 kontrata zgjidhjeje për kompensimin e dëmit jomaterial nga kafshimi i qenve endacak.

Në tremujorin e parë të vitit 2024 është përgatitur Informata për gjendjen e pronës së Komunës së Tuzit.

Sekretariati gjatë vitit 2024 ka iniciuar dhe zhvilluar procedura për shpronësimin e patundshmërive në territorin e Komunës në përputhje me Planin Zhvillimor Strategjik të Komunës së Tuzit.

Në përmbarrim publik është duke u zhvilluar një procedurë përmbarrimore në bazë të dokumentit përmbarrimor për shkak të mosrespektimit të kontratës për kompensimin e pajisjes komunale të truallit ndërtimor.

PUNËT E PËRKTHIMIT

Një nga përgjegjësitë themelore të Sekretariatit është të përfaqësojë palën, d.m.th. Komunën, dhe në këtë cilësi, Sekretariati është i detyruar të marrë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme, të studiojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale marrëdhëniet kontestuese dhe të përfaqësojë në mënyrë efikase dhe cilësore interesat e Komunës.

Meqenëse procedurat kryesisht zhvillohen para gjykatave dhe organeve kompetente administrative në të cilat Sekretariati, ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, duket se përfaqëson njërin nga të pandehurit, komunën e Tuzit, shpejtësia e përfundimit dhe dinamika e lëndëve varet nga gjykatat dhe nga organet e tjera administrative para të cilave zhvillohet procedura.

Në periudhën raportuese, gjithsej 109 procedura ishin në proces apo të përfunduara ligjërisht para gjykatave dhe organeve tjera kompetente administrative.

Prej tyre, 11 procedura kanë qenë në Gjykatën Themelore në Podgoricë, dhe 98 procedura në Gjykatën Administrative.

PUNËT ADMINISTRATIVE

Sekretariati gjatë periudhës raportuese ka sjellë 8 Vendime nga marrëdhëniet nëpunës-punonjës.

BASHKËPUNIM ME ORGANET E TJERA

Sekretariati ka vendosur bashkëpunim me organe dhe shërbime në nivel të komunës së Tuzit, si dhe bashkëpunim me organet shtetërore dhe organet dhe shërbimet e administratave tjera lokale. Ky bashkëpunim konkretizohet veçanërisht me dorëzimin e rregullt të informatave të parapara si: Informacioni për gjendjen e pronës, Raporti i punës, Raporti i veprimeve në çështje administrative, Propozimi për programin e punës dhe plani i personelit, të cilat i dorëzohen Kryetarit të Komunës dhe / ose Kryeadministratori. Në përputhje me përgjegjësitë e tij, Sekretariati për Pronë vendos bashkëpunim të rregullt me Administratën e Pasurive të Paluajtshme, i cili është veçanërisht i intensifikuar në procedurat e shpronësimit, vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe dorëzimin e të dhënave kadastrale.

TRANSPARECA NË PUNË

Sekretariati është plotësisht i përkushtuar për zbatimin e parimeve të hapjes dhe transparencës në punën e organeve të administratës lokale. Në këtë drejtim, duke respektuar këtë parim, të gjitha vendimet, udhëzimet e brendshme, rregulloret, njoftimet etj. janë publikuar në ueb faqen e komunës së Tuzit.

ORGANIZIMI DHE TRAJNIMI I STAFIT

Puna e Sekretariatit organizohet në kuadër të Departamentit të Pronës dhe Departamentit të Përfaqësimit. Në datën e dorëzimit të këtij raporti, në Sekretariat ishin të punësuar pesë persona: një sekretar, një ndihmës sekretar, dy zyrtarë dhe një nëpunës me kontratë pune të pacaktuar.

KONKLuzioni DHE PROPOZIMI I MASAVE

Vitin e kaluar, Sekretariati për Pronën ka vepruar me shpejtësi në zonat në juridiksionin e tij, pavarësisht se procedura e ndarjes së pronës ndërmjet Komunës së Tuzit dhe Kryeqytetit Podgorica nuk ka përfunduar, gjë që paraqiste një problem të madh, veçanërisht në dhënien e pëlqimit për vendosjen e servitutit aktual mbi pjesët e parcelave kadastrale në rrethin administrativ të Tuzit, me të cilat ka të drejtë të disponojë Kryeqyteti Podgorica.

Gjithashtu, një nga sfidat me të cilat Sekretariati për Pronën përballlet në vazhdimësi në punën e tij është joefikasiteti në punën e Administratës së Pasurive të Paluajtshme, e cila përfundimisht rezulton me ngecje në zbatimin e projekteve të planifikuara.

7. „VODOVOD I KANALIZACIJA – UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI” sh.p.k.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Vodovod i kanalizacija/Ujësijellësi dhe kanalizimi" Tuz është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal - Tuzi, me numër 01-030/13-747 datë 24.11.2021. i cili u botua në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – Rregulloret komunale" nr. 22/21.

Shoqëria është themeluar si një anëtar i vetëm, ndërsa themelues i Shoqërisë është Kuvendi i Komunës së Tuzit.

Rregulloret ligjore të aktiviteteve të Shoqërisë: grumbullimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit.

Aktivitet e Shoqërisë përcaktohen me aktin e themelimit dhe me statut dhe kryen këto veprimtari komunale me rëndësi publike:

- Furnizimi publik me ujë,
- Menaxhimi i ujërave atmosferike.

Shoqëria menaxhohet nga Themeluesi në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me Vendimin për themelimin e Shpk "Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë.

Aktivitet kryesore të Shoqërisë

Shpk "Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz ofron shërbime të furnizimit me ujë për gjithsej 4670 shfrytëzues, nga të cilët kategoria e personave fizikë është 4442 dhe ajo e personave juridikë 228.

Çmimi i ujit për kategorinë e konsumatorëve në vitin 2024 ishte 0.3920 euro/m³. Çmimet përcaktohen në bazë të Metodologjisë për përcaktimin e çmimeve për kryerjen e veprimtarive të rregulluara komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" nr. 56/20).

Kapacitetet kadrovike

Organizimi i Shoqërisë rregullohet nga Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shpk "Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz, me numër 350/24 datë 01.03.2024.

Për funksionimin e rregullt të Shoqërisë është angazhuar numri i nevojshëm i punonjësve. Më 31 dhjetor të vitit raportues, në Shoqëri ishin të punësuar gjithsej 47 punonjës.

Të ardhura nga veprimtaria e Shoqërisë

Në vitin raportues të Shpk "Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz prej me 01.01.2024. deri më 31.12.2024, mund të konkludohet në vijim:

- Ndonëse Shpk "Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz është relativisht e re në sistemin e shoqërisë që merren me furnizimin me ujë të qytetarëve dhe që në periudhën raportuese është përballur me sfida të shumta, Shoqëria megjithatë ka arritur të sigurojë furnizim të vazhdueshëm me ujë të pijshëm që plotëson standardet e përcaktuara në këtë zonë, për të gjithë qytetarët dhe subjektet afariste në territorin e Tuzit.

- Çmimi i shërbimit të ujësjiellësit për të gjithë shfrytëzuesit ishte 0,3920€
- Gjatë vitit raportues Shoqëria ka faturuar në total 466,192,78 euro (pa TVSH);
- Gjatë vitit raportues, Shoqëria ka pranuar 48,005 euro të hyra nga shërbimet (pa TVSH);
- Norma totale e arkëtimit të Shoqërisë në vitin 2024 është 78.88%.
- Nuk ka pasur pretendime të dyshimta dhe kontestuese.
- Duke pasur parasysh se niveli i arkëtimit dhe balanca e fondeve në dispozicion janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionimin e qëndrueshëm, rezultati i arritur i mundëson shoqërisë të funksionojë normalisht dhe të realizojë të gjitha detyrimet e marra deri më tani.
- Shoqëria nuk kishte detyrime krediti në vitin 2024.
- Shoqëria ka kryer me sukses të gjitha detyrat brenda juridiksionit të saj.

Të ardhurat tjera

Gjatë vitit raportues, Shoqëria ka realizuar të hyra edhe nga dotacionet, gjegjësisht transferet nga Komuna e Tuzit si themelues, në shumën prej 200,000.00 euro.

8. „KOMUNALNO – KOMUNALE” sh.p.k.

SHERBIMI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE LOKALE, VARREZAVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve lokale, varrezave dhe zonave publike ka kryer mirëmbajtjen dhe rregullimin e zonave të gjelbra publike nëpërmjet mirëmbajtjes së pemëve, gardheve, lëndinave, ujitjes, plehërimit, krasitjes, përgatitjes së terrenit dhe mbjelljes së luleve sezonale, kositjes memakineri dhe manuale të zonave, mirëmbajtjes së inventarit të parkut, lyerjes së stolave, vendosjes së kazanëve për mbeturina, vendosjen e tableva paralajmëruese e sensibilizuese "Ndalohe hedhja e mbeturinave", pastrimi i mbeturinave, heqja e pemëve të thata ose degëve të rëna sipas nevojës, ngarkimi dhe transportimi i mbetjeve të gjelbra, prerja e degëve të larta dhe një sërë veprimesh të tjera të nevojshme, të gjitha me qëllim mbrojtjen e gjelbërimit dhe mjedisit.

Sipërfaqet e gjelbra të cilat rregullisht i ka mirëmbajtur ky shërbim:

- Parku në Qendër të Tuzit
- Sheshi "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"
- Sipërfaqën e gjelbër përreth Komunës së Tuzit
- Rripa të gjelbër përreth Parkingut
- gjelbrimin nga komuna drejt qendrës së Tuzit
- Sipërfaqën e gjelbër pranë QKI "Malësia"
- Sipërfaqën e gjelbër pranë QKI në Sukruq
- Shtrati i Lumit Urrela
- Kroni i Vitojës
- Këndet e lojërave në mbarë Malësinë
- Gjatë sezonit të verës, mirëmbajtja e plazheve në Lumin Cem

Në vitin 2024 u krye rregullimi, rinovimi dhe përkujdesja e materialit bimor, duke përfshirë kositjen e rregullt të lëndinës, pastrimin e shtigjeve, shkurtimin e pemëve dhe shkurreve dhe mbjelljen e luleve, shkurreve dhe fidanëve të tjerë sezonalë. Plehërimi i rregullt me plehra minerale të mbjelljeve afatgjata kryhet dy herë në vit. Kositja e barit në parkun e Tuzit, sheshi "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", hapësirat e gjelbra pranë Komunës, hapësirat e gjelbra në Bulevardin Tuz-Pogoricë dhe oborri i QKI-së Malësia, kryheshin rregullisht 3 herë në muaj gjatë sezonit të rritjes dhe një herë në muaj, në muajt e tjerë, së bashku me gërryerjen dhe largimin e mbeturinave. Kositja e sipërfaqeve të tjera të gjelbra publike është bërë sipas nevojës, d.m.th. 3 herë në vit.

Mirëmbajtja e trotuareve në Tuz, Dinoshë, Miljesh, Dushiq (kositje e bordurave anësore), 3 herë në muaj gjatë sezonit të rritjes dhe një herë në muaj, në muajt e tjerë.

Për nevojat e komunës dhe organeve të saj, shërbimi ka kryer detyra si instalimi i ngadalësuesve të shpejtësisë, heqja e billbordave, vendosja e sinjalistikës së trafikut, etj. Gjithashtu, në bashkëpunim me Sekretariatën për Projektet dhe projektin NERA, kemi realizuar 10 miniparqe me 20 stola, 10 kosha plehrash dhe 80 bimë të mbjellura në vendet e përdorura për grumbullim të palejueshëm të mbeturinave, si dhe në bashkëpunim me Eko Fondin u realizua projekti "Tuzi i Gjelbër", i cili i ndryshoi tërësisht pamjen qytetit.

Gjatë vitit, u bënë përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës komunale duke vendosur kosha mbeturinash në zonat e piknikëve, parqeve dhe zonave të tjera publike ku u vlerësua e nevojshme. Gjithashtu vendosja e tabelave shoqëruese "NDALOHET HEDHJA E MBETURINAVE" në vendet ku nuk lejohet.

Mirëmbajtja e varrezave

Shoqëria, në përputhje me mundësitë e saj, mirëmban varrezat në territorin e komunës së Tuzit, ku përfshihet kositja dhe rrafshimi i terreneve. Punimet kryheshin jashtë planit, varrezat kositeshin më shumë se sa ishte planifikuar, në disa vende deri në 5-6 herë në vit, varësisht nga nevoja dhe mundësitë.

Sipërfaqja e përgjithshme e varrezave që mirëmbahen në territorin e Komunës së Tuzit është 221.129.000 m².

RB	Mjesto / Vendi	m²
1	Groblje Tuzi / Varreza	86 870
2	Groblje Gruda / Varreza	5250
3	Groblje Hoti / Varreza	16809
4	Groblje Vranj- Vladne - Lekaj - Dušići / Varreza Vrane, Vllanë, Lekaj, Dushiq	47105
5	Groblje Zatrijebač / Varreza Triesh	10 000
6	Groblje Dinoši / Varreza Dinoshë	27 156
7	Groblje u naselju Koći / Varreza Kojë	2 000
8	Groblje Vuksanlekaj / Varreza	9 000
9	Groblje Miljes / Varreza Mileshe	7556
10	Groblje Omerbožaj / Varreza OmerBozhaj	4800
11	Groblje Krševo / Varreza Kshevë	4583
	Ukupno / Totali	221 129

Mirëmbajtja aktuale e rrugëve

Spektori i shërbimeve komunale është përgjegjës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrjetit rrugor lokal 241 km të gjatë.

Duke marrë parasysh rindërtimin e një numri të madh të rrugëve nga Komuna e Tuzit, gjendja aktuale e konstruksionit të rrugëve lokale është në nivel të kënaqshëm.

Aktivitetet gjatë vitit 2024:

- Pastrimi i rrugës dhe elementëve të tjerë të rrugës brenda kufijve të brezit rrugor,
- Arnimi dhe mbushja e vrimave në pjesët e dëmtuara të rrugëve lokale.
- Kositja e bimësisë në anë të rrugës (1 metër gjerësi),
- Prerja dhe shkurtimi i bimësisë dhe shkurreve për shikueshmëri më të mirë të rrugës (1 metër gjerësi),
- Pastrimi i kanaleve,
- Pastrimi dhe heqja e rrëshqitjeve
- Mirëmbajtja dimërore
- Zëvendësimi i grilave të kullimit të thyera dhe që mungojnë

Sanimi dhe mbushja e gropave në pjesët e dëmtuara të rrugëve lokale

Gjatë vitit 2024, shërbimi ka riparuar gropat në rrugët lokale aty ku është e nevojshme. Pjesa që do të riparohet duhet pastruar nga rrënojat dhe pluhuri, më pas të pritet dhe në fund të mbushet me asfalt.

Mirëmbajtja e terrenit të Stadiumit të qytetit dhe hapësirave të gjelbra përreth

- Mirëmbajtja e rregullt e fushës së barit në stadiumin e qytetit (kositje, vaditje, shtim humusi, rëre, plehërim, mbrojtje, trajtim, etj.)
- Punime të jashtëzakonshme në terren, ndërrimi i terrenit në zonat kritike dhe punë të tjera në përputhje me terrenin dhe kushtet atmosferike.
- Rregullimi i spërkatësve në sistemin e ujitjes në stadiumin e qytetit
- Në terren është kryer mirëmbajtja e rregullt e higjienës
- Lyerja i linjave dhe portave.
- Vendosja e reklamave
- Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra përreth stadiumit

SHËRBIMI I PASTRIMIT

Detyrat e mirëmbajtjes së pastërtisë së hapësirave publike dhe largimit të mbetjeve komunale nga këto zona i kryen “Komunalno/Komunale” e Tuzit, ndërsa detyrat e ruajtjes së pastërtisë së zonave të tjera i kryejnë personat juridik dhe fizik që menaxhojnë ose përdorin këto zona. Grumbullimi i mbetjeve për këta persona kryhet nga Kompania në bazë të një faturë apo kontratë.

Programi i vitit 2024 parashikon mirëmbajtjen, pastrimin, dinamikën dhe mënyrën e ruajtjes së pastërtisë publike, largimin dhe asgjësimin e mbetjeve komunale dhe atyre të forta nga qyteti dhe zonat periferike, si dhe sasinë e përafërt të burimeve financiare për zbatimin e këtij programi. Ashtu siç ishte planifikuar, mbetjet po transportohen në landfillin sanitar “Livade”. Grumbullimi i mbetjeve po ndjek dinamikën e planifikuar. Qendra e qytetit pastrohet dy herë në ditë, vendbanimet pastrohen dy herë në javë, ndërsa personat juridikë, me ftesë të tyre ose sipas nevojës. Mbetjet e mëdhaose të forta pastrohen çdo ditë pune ose sipas nevojës.

Frekuenca e pastrimit të hapësirave publike në qendër të qytetit sigurohet me punësimin e 2 punëtorëve në ambiente publike jashtë sezonit. Për mirëmbajtjen e hapësirave publike në zonat periferike dhe rurale janë punësuar 17 punëtorë të cilët kanë ruajtur vazhdimisht pastërtinë e sipërfaqeve të gjelbra publike.


Mirëmbajtja mekanike e hapësirave publike është bërë sipas kërkesave të policisë komunale dhe nevojave të evidentuara për deponimin e pakontrolluar të mbeturinave nga qytetarët, mysafirët dhe subjektet afariste.

Pastrimi i rrugëve përfshin zbatimin e: grumbullimit manual të mbetjeve, grumbullimit të mbeturinave me automjet të posaçëm, asgjësimit dhe depozitimit të mbetjeve natyrore dhe artificiale komunale dhe të tjera (heqja e pjesëve të mobiljeve të hedhura, mjeteve teknike, degëve, rrënojave, etj.)

Me kërkesë të autoriteteve komunale (Sekretariati për Vetëqeverisjen Lokale dhe Organizata Turistike), në manifestimet dhe festimet e festave që organet e lartpërmendura organizuan gjatë vitit, Shqipëria jonë rregullisht mirëmbante dhe pastronte ambientet ku zhvilloheshin aktivitetet.

Në landfillin sanitar të Livade u depozituan gjithsej 5349.18 ton mbetje komunale, të cilat i depozituam nga janari 2024 deri në dhjetor 2024.

Transportimi i mbetjeve në Landfilldin LIVADE, 2024



9. „PIJACE – TREGU” sh.p.k.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar „Pijace/Tregu” Tuz u themelua në fund të vitit 2021 dhe filloi aktivitetin në fillim të vitit 2022.

Konkretisht, Kuvendi i Komunës së Tuzit, në mbledhjen e mbajtur më 24 nëntor 2021, ka sjellë Vendimin për themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar „Pijace/Tregu” Tuz, me seli në Tuz në adresën Tuz pn („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale” nr. 40/21), si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar njëanëtarëshe.

Me këtë, Shoqërisë iu mundësua të marrë në menaxhim Tregun e Mallrave të Përziera, i cili më parë ishte nën juridiksionin e Kryeqytetit, si dhe Tregun e Gjellbër, i cili deri atëherë menaxhohej nga SHPK „Komunalno/Komunale” Tuz.

Aktivitetet kryesore dhe dytësore të Shoqërisë, për të cilat ajo është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Ekonomike, përcaktohen me Statutin e Shoqërisë dhe më Kontratën për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale. Sipas Statutit, aktivitetet kryesore të Shoqërisë janë:

- ndërtimi, mirëmbajtja dhe administrimi i objekteve të tregut;
- mbajtja e higjienës së përgjithshme në hapësirat e tregut dhe në objektet e tjera në pronësi të Komunës së Tuzit;
- kryerja e detyrave të tjera me interes publik.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë

Gjatë vitit 2024 (në tekstin e mëtejshëm: viti raportues), Shoqëria administroi Tregun e Mallrave të Përziera dhe Tregun e Gjellbër në Tuz, kapacitetet hapësinore të të cilave i paraqesim në vijim.

Tregu i Mallrave të Përziera ka 426 hapësira shitjeje me një sipërfaqe totale prej 5.278 m².

Tregu i Gjellbër përbëhet nga 22 stenda për shitjen e frutave dhe perimeve, një sektor për djathë dhe mish, gjashtë vende shitjeje për peshk dhe gjashtë vende shitjeje për lule. Brenda Tregut të Gjellbër ka gjithashtu një hapësirë biznesi që jepet me qira nga Shoqëria.

Që nga fillimi i vitit raportues, ka filluar zbatimi i çmimeve të reja në objektet e tregut të menaxhuara nga kjo Shoqëri.

Kapacitetet kadrovike

Për funksionimin e rregullt të Shoqërisë, është angazhuar numri i nevojshëm i punonjësve. Më 31 dhjetor të vitit raportues, Shoqëria kishte gjithsej 37 punonjës.

Të ardhurat nga aktiviteti i Shoqërisë

Në vitin raportues, të ardhurat vetanake të Shoqërisë ishin gjithsej 557.980,40 euro.

Vlen të theksohet se shkalla e arkëtimit të të ardhurave nga përdoruesit e shërbimeve të tregut ishte në nivel rekord prej 97%.

Të ardhurat e tjera

Gjatë vitit raportues, Shoqëria gjithashtu realizoi të ardhura nga donacionet, domethënë transferet nga Komuna e Tuzit si themelues, në shumën prej 80.000,00 euro.

10. IP QKI „MALËSIA” TUZ

Pasqyrë e shkurtër e aktiviteteve të mbajtura dhe realizimi i tyre

Programi artistik i QKI “Malësia” ka përfshirë një larmi aktivitete të ndryshme, duke filluar nga artet figurative, mbrëmjet autoriale, promovimet, pjesët teatrale, eventet kinematografike e deri te aktivitetet e organizuara nga shoqatat kulturo-artistike që veprojnë në komunën tonë të cilat kanë ruajtur dhe promovuar elementët më thelbësorë të identitetit tonë kulturor.

Ndër aktivitetet më të spikatura të arteve figurative veçojmë ekspozitën personale të piktorit nga Malësia, Nikollë Nikprelaj. Kjo ekspozitë solli një udhëtim emocional për vizitorët, duke u ofruar atyre një mundësi unike për të shijuar artin nga një këndvështrim i ri.

Tre ekspozita të tjera, të cilat patën impakt të madh dhe ishin veçanërisht të dobishme në promovimin e kulturës shqiptare, ishin:

- **Ekspozita e kartolinave historike nga Andre Jakova (Shkodër)** – Një koleksion i rrallë nga vitet 1914-1918, që solli një perspektivë unike mbi peizazhin dhe trashëgiminë kulturore të asaj periudhe.
- **Ekspozita e artizanateve shqiptare nga mjeshtri Zef Gjini (Shkodër)** – Një vlerësim i mjeshtërisë tradicionale dhe trashëgimisë së pasur artizanale, e trashëguar brez pas brezi.
- **Ekspozita për shkollat fillore të Malësisë** – Një iniciativë e veçantë, organizuar për herë të parë, ku nxënësit patën mundësinë të pikturonin në vendngjarje si pjesë e një gare dhe më pas veprat e tyre u ekspozuan për publikun.

Ky vit ishte gjithashtu i pasur për skenën teatrale, duke ofruar një sërë shfaqjesh me vlera artistike të mëdha. Këto shfaqje jo vetëm që trajtuan tematika të rëndësishme, por gjithashtu u pritën me entuziazëm nga publiku, duke lënë një ndikim të fuqishëm në spektatorët.

Disa nga shfaqjet më të dalluara ishin:

- **"DR. Gjilpëra" nga Faik Konica** – Një vepër satirike e sjellë në skenë në një mënyrë të freskët dhe dinamike, e cila u mirëprit jashtëzakonisht mirë nga audienca.
- **"Burra pa gra"** – Një komedi që, përmes ironisë dhe humorit, trajtoi realitete të hidhura shoqërore.

- **"O Zot, O Zot, e zoja e shpis"** – Një shfaqje që, përmes skenografisë moderne dhe një regjie inovative, trajtoi tema të ndjeshme si maskuliniteti dhe patriarkati në shoqërinë shqiptare.

Këto shfaqje konfirmuan edhe një herë rëndësinë e teatrit si hapësirë reflektimi dhe argëtimi, ku arti jo vetëm që pasqyron realitetin, por edhe e sfidon atë me kreativitet dhe mjeshtëri.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës sonë është bashkëpunimi me shoqatat kulturore dhe organizatat joqeveritare në komunën tonë. Këto bashkëpunime kanë rezultuar të suksesshme dhe janë mbështetur vazhdimisht nga institucioni ynë.

Veçojmë disa nga aktivitetet më të rëndësishme në këtë drejtim:

- **SHKA "Besa" nga Trieshi**, e cila sjell gjithmonë frymën e traditës me shumë përkushtim.
- **SHKA "Koha" nga Dinosa**, që ka një rol të rëndësishëm në edukimin kombëtar të brezave të rinj.
- **SHKA "Ramadan Sharkiq" në Tuz**, një model i ruajtjes së harmonisë dhe vlerave që karakterizojnë jo vetëm Malësinë, por edhe Malin e Zi në tërësi
- **Aktivitetet e SHKA "Rapsha" e Hotit**, e cila me përkushtim të madh ruan dhe promovon vlerat tona tradicionale, si mikpritja, burrëria dhe besa.
- **Koncerti për fëmijë i trupës së baletit "Tip Toe"**, nën drejtimin e Leonora Dedivanajt.

Sa i përket programit edukativo-arsimor, gjatë këtij viti kemi treguar një përkushtim të veçantë. Organizimi i promovimeve të librave, bisedave me autorë dhe garave në recitim ka qenë pjesë e rëndësishme e aktiviteteve tona.

Një nga ngjarjet më të veçanta ishte **gara e recitimit me rastin e 7 Marsit**, e cila përfshiu të gjitha shkollat shqipe në Malin e Zi. Ky event u prit me interes të madh dhe u vlerësua si një nismë e suksesshme nga mësuesit dhe drejtuesit shkollorë, ndaj synojmë ta shndërrojmë në një traditë të përvitshme.

Ndër promovimet e librave, vlen të përmendet ai i autorit **Ben Blushi**, i cili u prit shumë mirë nga publiku ynë. Po ashtu, kemi pasur kënaqësinë të promovojmë librat e bashkëvendësve tanë në emigracion, si **Pashko Rr. Camaj** dhe **Age Gjokaj Ivezaj**, duke u dhënë një mundësi për të ndarë krijimtarinë e tyre me komunitetin tonë.

Vlerësimi dhe përfundimi mbi zbatimin e Programit të Punës për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, QKI "Malësia" ka realizuar **43 aktivitete** nga Programi i Punës, duke përfshirë fusha të ndryshme si muzika, teatri, filmi, arti figurativ dhe arsimi. Këto aktivitete kanë pasur një ndikim të madh në komunitetin tonë, duke u mirëpritur me interes dhe duke nxitur pjesëmarrjen e gjerë të publikut.

Për më tepër, kemi realizuar një sërë programesh në bashkëpunim me **Komunën e Tuzit dhe institucionet e saj**, duke forcuar kështu lidhjet mes kulturës dhe administratës lokale. Ky angazhim i përbashkët ka rezultuar në projekte të suksesshme që kanë pasuruar jetën kulturore të qytetarëve tanë.

Në të ardhmen, synojmë të vazhdojmë me të njëjtin përkushtim për të ruajtur dhe zhvilluar më tej kulturën, traditën dhe vlerat tona kombëtare, duke sjellë gjithnjë risi dhe mundësi të reja për komunitetin tonë.

Realizimi i buxhetit për vitin 2024 në vlerë absolute, është 359,398,85 euro, ose 101,76% krahasuar me planin (353,166,90 euro). Nëse krahasojmë realizimin e të ardhurave për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 (305,561,62 euro), shohim se realizimi i të hyrave në vitin 2024 ishte 17,62% më i lartë.

Jemi të kënaqur me realizimin e buxhetit të vitit 2024, obligimet ndaj punëtorëve janë shlyer rregullisht, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera rrjedhëse të Qendrës. Në vitin 2024 gjithësej janë shpenzuar 334 199,71 euro.

Kënaqësi është se QKI “Malësia” këtë vit arriti të animojë audiencën, e cila i vizitoi aktivitetet e kësaj shtëpie në numër shumë më të madh se në vitet e kaluara.

Të dhënat tona të brendshme (statistikore) tregojnë se programet dhe aktivitetet kulturore të organizuara nga QKI “Malësia” gjatë vitit 2024 janë vizituar nga afërsisht 4500 shikues. Edhe pse nuk është numër i mjaftueshëm dhe të cilit i pretendojmë ne si Institucion, prapëseprap paraqet një rritje prej 10% në krahasim me vitin paraprak.

Institucioni është bërë i njohur për programet e tij cilësore dhe të zgjedhura mirë, ndaj edhe aktivitetet tona të ardhshme do të drejtohen në atë drejtim, si dhe për faktin se roli i institucionit nuk është vetëm kulturor, por edhe informues dhe edukativ.

11. ORGANIZATA TURISTIKE TUZ

Organizata Turistike e Tuzit gjatë vitit 2024 ka kryer detyrat dhe aktivitetet e parapara me Statut dhe Vendimin mbi Themelimin e Organizatës Turistike të Tuzit.

Të hyrat e Organizatës Turistike të Tuzit bazohen kryesisht në të hyrat nga taksa e grumbulluar turistike, kontributet e anëtarësimit, mjetet nga buxheti i komunës së Tuzit, sipas programeve të veçanta, si dhe nga burime të tjera.

Sa i përket të ardhurave për vitin 2024, Organizata Turistike ka realizuar të ardhura 44,268.61 € nga taksa turistike dhe kontributet e anëtarësimit në Organizatën Turistike.

Nga buxheti i Komunës së Tuzit gjatë vitit 2024 janë ndarë gjithsej 100,000.00€.

Gjatë vitit 2024 është shpallur konkursi për përzgjedhjen e kopshtit dhe tarracës më të bukur, evente të organizuara në mënyrë të pavarur: Kungull - Fest 2024, si dhe aktivitetet e mëposhtme që janë mbështetur logjistikisht dhe financiarisht: Pazari i Dimrit në Malësi, Logu i Bjeshkës - festa e Shën Shtjefnit, Karnavalet në Tuz, Panairi i Ushqimit Tradicional në Triesh dhe të ngjashme.

Gjatë vitit 2024, kontributi më i madh i OT të Tuzit ishte në promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të Tuzit, përmes emisioneve televizive dhe radiofonike, revistave turistike, panireve dhe mediave të tjera.

Gjatë vitit 2024, organizata ka kryer prokurimin publik të mallrave, materialeve dhe shërbimeve në vlerë 37,895,69 pa TVSH.

Sipas të dhënave të datës 31. 12. 2024, në OTT ishin të punësuar 4 punëtorë dhe drejtori ekzekutiv.

12. KLUBI I FUTBOLLIT „DEÇIQ“

Bazuar në programin e punës me numër 03-265/2023 të datës 8 dhjetor 2023, gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme të planifikuara në atë plan.

Kanë përfunduar analizat e raportit të punës për vitin 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e licencimit për garat e UEFA-s.

U kryen edhe aktivitete për ndërtimin e një tribune me ambiente përcjellëse, krijimin e bazës së fushës kryesore, hapjen e dy puseve dhe përgatitjen për vendosjen e një sistemi të ri vadatitjet, të cilat kanë përfunduar dhe kemi kaluar në objektin e ri.

Kemi forcuar në mënyrë adekuate stafin tonë të lojtarëve dhe trajnerëve për ekipin e kadetëve dhe kategoritë më të reja.

Përgatitjet dimërore në Antalia, Turqi, Janar - Shkurt 24.01.2024 deri më 09.02.2024, si dhe përgatitjet verore 12 ditore në Zlatibor, i kemi përfunduar në mënyrë cilësore dhe në kohë.

Administrata punon me zell dhe përfundoi me sukses licencimin e klubit për kompeticionet evropiane.

Në vitin 2024 vazhduam me edukimin dhe trajnimin e trajnerëve duke i dërguar në edukim shtesë për vazhdimin e licencave, përkatësisht 5 trajnerë me licencë A, një trajner me licencë Pro dhe 2 trajnerë me licencë C. Duhet të theksojmë gjithashtu se kemi shtuar edhe 2 trajnerë me licencë B dhe një me licencë A në kategoritë më të reja në mënyrë që djemtë tanë të kenë trajnime sa më cilësore.

Gjithashtu gjatë përgatitjeve kemi përmirësuar dhe forcuar kapacitetet administrative për përgatitjen dhe organizimin e ndeshjeve.

Gjatë vitit 2024 janë organizuar ndeshje garuese dhe testuese:

42	SENIORËT	(Ekipi A)	Liga e Parë Malazeze / testuese dhe garuese
6	SENIORËT	(Ekipi A)	Uefa Champions dhe Uefa Conferene League
47	JUNIORËT	(U 19)	
40	KADETËT	(U 16)	
20	PIONERËT	(U 14)	
24	SHPRESAT	(U12)	
40	PARASHPRESAT	(U10).	
Total : 219 ndeshje			

Si rezultat i punës së mirë dhe cilësore, në vitin 2024 u arritën rezultate historike:

Për herë të katërt në historinë e klubit, ekipi i kadetëve luajti në gjysmëfinale të Kupës së Malit të Zi.

Viti 2024 u shënuar si më i suksesshmi në ekzistencën e klubit, pasi klubi fitoi titullin kampion dhe kaloi në raundin e tretë të Ligës së Konferencave të UEFA-s, ku arriti një përparim të madh për futbollin malazez, duke u renditur në vendin e 47-të nga gjithsej 55 federata në Evropë.

Për herë të dytë në historinë e klubit, të gjitha kategoritë më të reja garuan në ligat e para të Malit të Zi, ku janë tani, që do të thotë se sportistët tanë kanë një ligë më të fortë dhe përparim më të mirë në futboll.

Klubi aktualisht është në vendin e katërt në tabelën e Ligës së Futbollit të Malit të Zi Meridianbet 1 dhe jemi kualifikuar në gjysmëfinalen e Kupës së Malit të Zi për herë të pestë.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur dy seanca të Asamblesë së Klubit dhe katër seanca të Bordit të Drejtorëve.

13. KLUBI I BASKETBOLLIT „DEÇIQ“

Klubi i basketbollit “Deçiq” në këtë sezon numëron 5 selekcione në mosha dhe gara të ndryshme të cilat janë nën kupolen e federates së basketbollit të Malit të Zi. Në këto selekcione ushtrojnë shumë të rinj dhe të reja nga komuna jonë, me të cilët punonë trajneri i licencuar si dhe koordinatori për mosha të reja.

Ju paraqesim raportin e punës për vitin 2024 të KK “DEÇIQ”. Duke parë rëndësinë e sportit në zhvillimin e komunitetit tonë, kemi krijuar një plan që mbështet rritjen dhe përmirësimin e basketbollit në Komunën e Tuzit.

Objektivat për vitin 2024 ishin:

- Rritja e numrit të anëtarëve dhe përmirësimi i cilësisë së trajnimeve: Me qëllim të përfshirjes së më shumë të rinjve dhe zhvillimit të aftësive të tyre sportive.
- Pjesëmarrja në kampe, kupa dhe turne brenda dhe jashtë vendit: Kjo do të ndihmojë në ekspozimin e lojtarëve ndaj konkurrencës së lartë dhe përvojave të reja.

- Angazhimi i rinisë në aktivitetet sportive: Promovimi i basketbollit si një sport i rëndësishëm për zhvillimin e të rinjve dhe krijimin e një baze të fortë për të ardhmen.

Kategoritë e përfshira:

- Seniorët (U23)
- Juniorët (U18-20)
- Kadetët (U16)
- Pionierët (U14)
- Pionierët më të rinj (U12)
- Si dhe ekipi I Vajzave

Shumicën e stervitjeve si dhe ndeshjet zhvillohen në sallën në Zet për arsye se sallat e shkollave tona nuk i përmbushin kushtet, andaj dhe me pa durim presim ndërtimin e palestrës sportive në Tuz ku dhe do të gjendet salla për basket, që do të na ndihmojë pa masë si në mënyrë materiale, ashtu edhe sportive.

KK “DEČIĆ” është përpjekur të sigurojë futjen e risive për rritjen e numrit të anëtarëve dhe përmirësimin e cilësisë së trajnimeve. Inovacionet janë realizuar përmes vizitave në kampet e basketbollit dhe pjesëmarrjes në kupa dhe turne basketbolli për të gjitha kategoritë.

Puna me fëmijët është organizuar në mënyrë që trajnerët mundësojnë çdo fëmijë të shprehë talentin e tij dhe të përmirësohet përmes trajnimeve dhe konkurrencës. Ne do të përpiqemi që basketbolli të mos jetë vetëm një hobi, por një mundësi për fëmijët e Tuzit të arrijnë rezultate të larta me punën dhe udhëzimet e trajnerëve tanë të dedikuar.

Në përpilimin e programit të punës janë marrë parasysh të gjithë elementët e rëndësishëm që lidhen me stërvitjen sportive, moshën e lojtarëve, parimet dhe metodat e punës, ekspertizën, përvojën dhe kreativitetin e trajnerëve. Kjo është bërë me synimin për të krijuar sportistë të suksesshëm nga fëmijë të talentuar. Ekipi I parë këtë sezon gjendet në pjesën e sipërme të tabelës ku gëzojmë një rezultat të kënaqshëm me një atmosferë të mirë në mes lojtarëve dhe stafit drejtues. Besojmë se investimi në sport është i mirë si për fëmijët tona ashtu edhe për komunën tonë në shtetin e Malit të Zi dhe më gjerë.

III. SHËRBIMET PROFESIONALE

1. SHËRBIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Shërbimi i kryetarit të komunës kryen detyrat që kanë të bëjnë me kryerjen e funksionit ekzekutiv të kryetarit të komunës.

Përveç se Shërbimi i kryetarit të komunës dhe njësitë tjera organizative të administratës lokale, kanë punuar në hartimin e dispozitave dhe akteve të tjera të cilat i sjellë kryetari i komunës, si dhe në përgatitjen e vendimeve dhe dokumenteve të tjera të cilat miratohen në kuvendin e komunës, ata kanë përcjellë realizimin e akteve të sjella nga kryetari i komunës dhe trupat punuese si dhe kanë shqyrtuar propozimet dhe ankesat e qytetarëve.

Ka përgatitur dhe organizuar kolegjiune dhe takime të kryetarit të Komunës me përfaqësuesit e administratës lokale, sipërmarrësit, institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera, njëkohësisht ka bërë evidentimin e pranimi të palëve dhe ka caktuar takime me kryetarin e Komunës, kurse varësisht nga natyra e kërkesave të palëve, i ka drejtuar në bisedime edhe tek drejtuesit e organeve të tjera dhe shërbimeve kompetente për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Jo më pak të rëndësishme janë takimet që Shërbimi i kryetarit ka organizuar me drejtues organizatash të ndryshme joqeveritare, pjesëtarë të komunitetit të biznesit, të artistëve, sportistëve, e deri te ato me qytetarë.

Kryetari i Komunës ka zhvilluar takime të rregullta me përfaqësues të institucioneve lokale dhe ndërkombëtare, duke diskutuar projekte të rëndësishme dhe duke forcuar bashkëpunimin për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

U zhvillua takimi me përfaqësuesit e Ministrisë së turizmit, ekologjisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit të veriut. Takimi pati në fokus ekologjinë në komunën e Tuzit. Konkretisht u diskutua për pastërtinë e kanionit të lumit Cem, gjegjësisht gomat e hedhura pranë lumit dhe zgjidhjen e këtij problemi, prandaj edhe u organizua një aksion për heqjen e këtyre gomave duke dëshmuar se të gjithë së bashku mund të kontribuojmë në mbajtjen e mjedisit tonë të pastër.

Manifestimi tradicional Karnavalet, u mbajt në muajin shkurt. Mu për këtë kryetari me bashkëpunëtorë u takua me kryetarin e OJQ “Karnavali - Koret”, Arton Gjokaj me bashkëpunëtorë, si organizator të manifestimit. Në lidhje me këtë, kryetari i komunës, kryetari i Kuvendit Fadil Kajoshaj dhe nënkryetari Fisnik Gjokaj së bashku me bashkëpunëtorë, në ditën e defiluet të mbrëmjes së fundit të Karnevaleve, pritën në takim përfaqësuesit e qyteteve karnevale të Malit të Zi dhe Shqipërisë pjesëmarrëse në manifestimin kulturor “Karnevali-Koret” në Tuz. Kryetari i komunës në fjalën e tij përshëndetësi tregoi se ky manifestim që për herë të 29 organizohet në Tuz ofron një mundësi që të promovohen vlerat vendase siç është turizmi, trashëgimia kulturore etj. ku së bashku me kryetarin e “Karnevali-Koret”, Arton Gjokaj bënë ndarjen e mirënjohjeve dhe falënderimeve për përfaqësuesit e pjesëmarrësve.

Komunën e Tuzit vizitoi Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj. Ai u prit nga kryetari i komunës me bashkëpunëtorë. Kryebashkiaku komplimentoi z. Gjellaj për sukseset e vazhdueshme në fusha të ndryshme, si për infrastrukturë, po ashtu edhe në fushën e kulturës dhe sportit. Ndërsa kryetari e falënderoi për financimin e sheshit të ri në Komunën e Tuzit nga ana e Bashkisë së Tiranës. Në takim u diskutua lidhur me bashkëpunimin e deritanishëm të Komunës së Tuzit me Bashkinë e Tiranës, dhe për hapat që do të ndërmerren për një bashkëpunim të vazhdueshëm.

Kryetari i Komunës, së bashku me sekretaren e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale, Marina Ujkaj, pritën në takim Fatmir Toçin, presidentin e Shtëpisë Botuese “Toena”, dhe Irena Toçin, drejtoreshën e përgjithshme të kësaj shtëpie botuese. Gjatë bisedës, u trajtuan mundësitë e

bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Tuzit dhe Shtëpisë Botuese “Toena”, duke pasur në fokus promovimin e kulturës, avancimin e edukimit dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta me ndikim në komunitetin lokal.

Së bashku me nënkryetarin Ivan Ivanaj dhe sekretarin për urbanizëm Lekë Ivezaj, kryetari i komunës priti në takim iniciatorët e projektit për rrugën e Deçiqit Mark Ivezaj, Nrekë Gjollaj dhe Nikollas Sinshaj. Gjatë takimit u diskutua për hapat konkretë të realizimit të këtij projekti të rëndësishëm për komunitetin dhe për përmirësimin e infrastrukturës në këtë zonë.

Kryetari, së bashku me bashkëpunëtorët, zhvilloi një takim konstruktiv me përfaqësuesit e Agjencisë për Investime. Gjatë takimit, u shkëmbyen informacione dhe ide të dobishme, të cilat do të jenë thelbësore për forcimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Në të ardhmën presim zhvillimin e mëtejshëm të nismave të përbashkëta që synojnë përmirësimin dhe realizimin e projekteve investuese në komunën tonë.

Gjatë takimeve të mbajtura me përfaqësuesit fetar dhe korin diplomatik të Malit të Zi, Kryetari i Komunës ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë për forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe promovimin e vlerave të paqes dhe tolerancës fetare në rajon. Ai, së bashku me Kryetarin e Kuvendit Fadil Kajoshaj dhe nënkryetarin e Komunes Ivan Ivanaj, pranoi Reisin e Bashkësisë Islame në Mal të Zi, Rifat ef. Fejziqin me bashkëpunëtorët e tij dhe përfaqësuesit e Bashkësisë Islame. Në takimin miqësor u bisedua për bashkëpunimin e këtyre dy institucioneve me rëndësi të posaçme për banorët e vendit. Gjatë bisedës bashkëbiseduesit u pajtuan se toleranca ndërfetare e banorëve të Komunës së Tuzit është shembull jo vetëm për mjedisin, por edhe për Malin e Zi e më gjerë, dhe në drejtim të ruajtjes dhe avancimit të së cilës duhet të punohet vazhdimisht.

Në vazhden e takimeve kryetari i komunës, priti ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Mal të Zi, SHS Zhaklina Peto. Tema të bashkëbisedimit ishin zhvillimet në Komunën e Tuzit, posaçërisht në sektorin e turizmit, si potencial i jashtëzakonshëm i Komunës sonë, si dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në fushat e kulturës, sportit, politikave të rinjve për të rritur rolin e tyre në hartimin e politikave rinore dhe vendimmarrjen vendore. Kryetari në mënyrë të përmblodhur e informoi ambasadorin me arritjet e komunës së Tuzit në mandatin e kaluar dhe me planet për zhvillimin e Komunës në të ardhmen ku vëmendje do të kushtohet, përmirësimit të infrastrukturës. SHS ambasadorja Peto, shprehu mbështetjen e Republikës së Shqipërisë për mirëvajtjen dhe zhvillimin e Komunës së Tuzit, dhe të gjithë trevave ku jetojnë shqiptarë në Mal të Zi, që është edhe obligim i shtetit amë.

Kryetari i Komunës së Tuzit u takua me përfaqësuesit e diasporës, duke theksuar rolin jetik që ata luajnë në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror të komunës, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm për të forcuar lidhjet me vendlindjen. Nga takimi që u mbajt me kryetarin e Shoqatës Shqiptaro-Amerikane “Malësia” nga Kalifornia – SHBA, Sherif – Sheki Krniq, vlen të përmendet se nga diaspora jonë malësore në Kaliforni, për nevojat e Komunës fituam në donacion, makinën për transportin e mbeturinave, që banorët e Tuzit dhe të Malësisë kanë rast ta shohin dita -ditës gjatë punës me të.

Një takim tjetër i kryetarit të komunës së bashku me nënkryetarin, Ivan Ivanaj u zhvillua me kryetarin e shoqatës „Jehona e Malësisë” nga Miçigani, Agron Dedivanaj me të cilin diskutuan mbi investimet dhe projektet që po realizohen në bashkëpunim me diasporë si dhe çfarë pritët të realizohet në të ardhmen në komunën tonë. Komuna e Tuzit velrëson kontributin që diaspora vazhdimisht jep për zhvillimin e komunës.

Kryetari gjithashtu u takua me kryetarin e Shoqatës Atdhetare “Malësia e Madhe” nga Michigan, Nrekë Gjollaj. Kryetari e njoftoi z. Gjollaj me aktivitetet e Komunës në rregullimin e infrastrukturës si dhe me aktivitetet e tjera që dita ditës po e shndërrojnë Malësinë në një zonë të vlefshme për jetesën e të gjithë qytetarëve të saj. Gjithashtu falënderoi diasporën, e në rastin konkret

shoqatën nga Michigani për kujdesin për vendlindjen, që më së miri shihet me aksionet siç ishte ndarja e bursave për studentët malësorë, që e kishte bërë shoqata një ditë përpara.

Gjatë vitit 2024, u zhvillua edhe një takim tjetër me përfaqësuesit e diasporës. Kryetari i komunës, së bashku me kryetarin e Kuvendit, Fadil Kajoshaj, nënkryetarët e komunës Ivan Ivanaj dhe Fisnik Gjokaj, sekretaren e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale, Marina Ujkaj, si dhe sekretaren e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural, Ismeta Gjoka zhvilloi një takim me përfaqësuesit e shoqatave humanitare nga diaspora, kryetarin e shoqatës „Malësia e Madhe“ nga New Yorku, Senad Lulanaj, kryetarin e Shoqatës atdhetare „Malësia e Madhe“ nga Michigani, Nrek Gjollaj, kryetarin e shoqatës Shqiptaro-Amerikane „Malësia“ nga Kalifornia, Sherif-Sheki Krniq si dhe kryetarin e shoqatës „Jehona e Malësisë“ nga Michigani, Agron Deditvanaj dhe Vilson Sinishtaj-përgjegjësi për strategjinë politike. Ky takim, i cili u mbajt në ambientet e komunës, kishte për qëllim forcimin e lidhjeve mes institucioneve lokale dhe diasporës, si dhe identifikimin e fushave ku mund të ndërmerren iniciativa të përbashkëta në dobi të komuniteteve në nevojë. Kryetari theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme që ka kontributi i diasporës shqiptare në zhvillimin e vendit. Ai shprehu mirënjohjen e tij të thellë për të gjitha përpjekjet dhe projektet që shoqatat kanë realizuar ndër vite dhe falënderoi përfaqësuesit e diasporës për angazhimin e tyre të palodhur dhe për kontributin e çmuar që po japin në promovimin e vlerave kombëtare dhe kulturore. Pas takimit, delegacioni zhvilloi një vizitë simbolike në sheshin ku do të vendoset busti i heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Ky bust, i cili pritet të ngrihet në shesh të ri, është një projekt i financuar nga diaspora, duke dëshmuar edhe një herë lidhjen e ngushtë të mërgates tonë me atdheun e tyre. Përfaqësuesit e shoqatave, të pranishëm në këtë vizitë, theksuan se ngritja e bustit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në këtë shesh nuk është vetëm një gjest simbolik, por edhe një mënyrë për të forcuar lidhjet mes diasporës dhe atdheut, duke kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kombëtare.

Kryetari i Komunës kishte kënaqësinë të priste Mark Nikollë Pjetrushin Lulgjuraj, një figurë e njohur dhe e respektuar në komunitet, i cili gjithmonë ka qenë pranë nevojave të Malësisë. Mark Lulgjuraj ka treguar përkushtim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e jetës së bashkëqytetarëve të tij, duke kontribuar në shumë aspekte. Kryetari i Komunës shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e vazhdueshëm të zotit Lulgjuraj dhe theksoi rëndësinë e individëve si ai, të cilët me përkushtimin e tyre i japin komunitetit mbështetjen dhe kujdesin e nevojshëm. Në këtë takim, u diskutuan gjithashtu iniciativa të reja për të përmirësuar më tej jetën në Malësi, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me institucioneve lokale.

Kryetari gjithashtu u takua me përfaqësuesit e pensionistëve, duke theksuar kontributin e tyre të çmuar në ndërtimin dhe zhvillimin e komunës si dhe rëndësinë e përmirësimit të kushteve të tyre për një jetë dinjitoze. Përfaqësuesit e pensionistëve e njoftuan kryetarin me organizimin të tyre në nivelin shtetëror dhe atë lokal, dhe me kërkesat që do të mundësonte një integrim më të gjerë të tyre në shoqëri. Aktiviteti i tyre lidhet ngushtë me lokalet e domosdoshme për veprimtarinë e tyre, që në Tuz janë krejtësisht të bazuar në Klubin e Pensionistëve dhe me nevojën e përmirësimit të këtyre kushteve në te.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në nivelin e Komunës së Tuzit është thelbësor për zhvillimin ekonomik, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e infrastrukturës. Përmes partneriteteve me qytete dhe organizata ndërkombëtare, komuna mund të përfitojë nga projekte zhvillimore, investime dhe programe të ndryshme që rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve. Gjithashtu, ky bashkëpunim ndihmon në promovimin e kulturës dhe identitetit lokal në një kontekst më të gjerë global. Në lidhje me këtë kryetari, së bashku me Fadil Kajoshaj, kryetarin e Kuvendit të Komunës, Ivan Ivanaj, nënkryetarin e Komunës dhe të tjerë bashkëpunëtorë, priti zonjën Oana Kristina Popa, ambasadore e BE-së në Mal të Zi, të shoqëruar nga anëtarët e delegacionit të Bashkimit Evropian: Orlando Fusco, këshilltar programor për tregun e brendshëm dhe menaxhim të financave publike, Melanie Bride, këshilltare programore për bashkëpunimin ndërkufitar dhe Vuk Vujnović, këshilltar për media dhe

informata. Në këtë takim përfaqësuesit e BE-së u njoftuan me statusin e Komunës së Tuzit, me investimet dhe punimet që nga themelimi i Komunës së plotë. Ndërkaq, sekretarja e Sekretariatit për Zhvillim dhe Projekte i njoftoi të pranishmit me programet dhe projektet, që Komuna e Tuzit i implementon në bashkëpunim me BE-në përmes bashkëpunimit ndërkufitar. Ambasadorja Popa tha se BE-ja mbështet projektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, ujërave të zeza, infrastrukturës hekurudhore, për të cilat komuna e Tuzit luan një rol të rëndësishëm përmes pozicionit të saj gjeografik, si një komunë që kufizohet me Shqipërinë dhe mund të shfrytëzojë fondet e përmendura edhe për zhvillimin e turizmit.

Në kuadër të projektit „Komunat për BE (M4EU)“, i financuar nga Delegacioni i BE-së në Mal të Zi u mbajt takimi në të cilin morën pjesë kryetari i Komunës, ushtruesja e detyrës së sekretarit për zhvillim dhe projekte, Adella Bahoviq, dhe përfaqësuesit e projektit, Branka Mraçević dhe Goran Gjuroviq ku diskutua për rëndësinë e këtij projekti në forcimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale për zbatimin e politikave të BE-së dhe shfrytëzimin e fondeve evropiane. Ky projekt është një mundësi e jashtëzakonshme për komunën tonë, e cila do të na ndihmojë të përmirësojmë shërbimet dhe të sigurojmë një menaxhim më efikas të burimeve financiare që ofron Bashkimi Evropian. Projekti do të zgjasë tre vjet dhe do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore dhe lokale.

Evaluatorët e BFC SEE dhe Sekretariati Teknik i Odës Ekonomike të Malit të Zi vizituan Komunën e Tuzit për të vlerësuar përpjekjet për Certifikimin e komunave me ambient të favorshëm për biznes. Komuna e Tuzit është në rrugë të mirë për të marrë certifikatën BFC, e cila do të tërhiqte investitorë dhe do të përmirësonte zhvillimin ekonomik lokal.

Në kuadër të projektit "Mini Smart Parqe," të bashkëfinancuar nga Ambasada Bullgare në Mal të Zi, janë vendosur 3 stola diellor në qytetin tonë! Lokacionet janë: pranë ndërtesës së Komunës, në qendër dhe në Sheshin e ri. Këto stola nuk janë thjesht vende të rehatshme për t'u ulur, por ofrojnë edhe energji të qëndrueshme për të karikuar pajisjet tuaja elektronike.

Më pas kryetari i komunës së bashku me bashkëpunëtorët: nënkryetarin, Fisnik Gjokaj dhe sekretaren e Sekretariatit për vetëqeverisjen lokale, Marina Ujkaj mori pjesë në Samitin B-40 në Tiranë. B-40 është Rrjeti i Qyteteve të Ballkanit i cili zgjati tri ditë. Shtyllat kryesore të Rrjetit janë: bashkëpunimin ndaj krizave dhe ndryshimeve klimaterike, zhvillimi ekonomik dhe kulturor dhe digjitalizimi e shërbimeve. Me këtë rast Tirana mori udhëheqjen e Rrjetit, që do të thotë se do të jetë përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve ndërmjet qyteteve të Ballkanit, por edhe nismëtare e projekteve të përbashkëta. Pas Stambollit e Athinës, Tirana është e treta që merr presidencën e B-40. Në samit ishin prezentë edhe kryetarët e komunave të Shkupit, Sarajevës, Prishtinës, Stambollit, Parisit etj.

Kryetari i komunës mori pjesë në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon, me temën "Turizmi rajonal dhe sfidat në sektorin e shërbimeve". Në këtë mbledhje, e cila u mbajt në Ulqin, morën pjesë përfaqësues të komunave dhe bashkive shqiptare në rajon. Kryetari bëri prezantimin e komunës, gjegjësisht fushës së turizmit. Ai shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me Unionin e Bashkive Shqiptare në Rajon dhe paraqiti synimin për të promovuar komunën e Tuzit si destinacion i mundësive turistike. Ky është një hap i rëndësishëm për të rritur ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin ndërmjet bashkive shqiptare në fushën e turizmit dhe zhvillimit rajonal.

Më pas në Tiranë u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon. Në fokus të diskutimeve ishte tema: "Bashkëpunimi Rajonal dhe Zhvillimi i Turizmit në Qytetet Shqipfolëse". Ky takim u shndërrua në një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe projekteve që synojnë zhvillimin e përbashkët të turizmit në rajon. Në këtë takim kryetari i komunës, theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit midis komunave për të promovuar potencialin turistik dhe kulturor.

Kryetari i komunës së bashku me kryetarin e Kuvendit të Komunës së Tuzit, Fadil Kajoshaj, nënkryetarët e Komunës së Tuzit Ivan Ivanaj dhe Fisnik Gjokaj, sekretaren Marina Camaj Ujkaj dhe sekretarin e Kuvendit Nermin Alibasic priti në vizitë kryetarin e Gjakovës, Ardian Gjini, dhe Kryetaren e Kuvendit të Gjakovës, Arbëneshë Kuqi me bashkëpuntorët e tyre. Takimi kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Tuzit dhe Gjakovës dhe krijimin e kushteve për projekte në fushën e kulturës. Vizita vazhdoi në "Mbrëmjen e Gjakovës" të organizuar për delegacionin mysafirë ku kryetari përshëndeti të ftuarit ndërsa kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini shprehu kënaqësinë për prezencën e tyre në komunën tonë dhe bashkëndau disa informacione të rëndësishme për Komunën e Gjakovës. Kjo ngjarje tregon se bashkëpunimi ndërmjet komunave është i rëndësishëm për zhvillimin e rajonit dhe për të adresuar çështje të përbashkëta.

Një ndër takimet më të bukura të kryetarit të komunës është ajo me moshën e më të rinjëve të komunës sonë. Ai së bashku me kryetarin e Kuvendit të Komunës së Tuzit, Fadil Kajoshaj si dhe nënkryetarin e Komunës së Tuzit, Fisnik Gjokaj pritën në vizitë nxënësit e klasave të pesta të shkollës fillore "Mahmut Lekiq". Kryetari pas mirëseardhjes i njoftoi nxënësit për mënyrën e organizimit të Komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, për kompetencat e saj dhe për aktivitetet që janë ndërmarrë dhe po ndërmerren në përmirësimin e kushteve të jetës së të gjithë qytetarëve të Malësisë. Është detyrë dhe obligim i yni ta përmirësojmë gjendjen aktuale dhe juve si pasardhës, t'ua lehtësojmë sadopak punën kur, një ditë ta merrni në dorë zhvillimin e vendit tuaj. Nikoqirët pastaj përgjigjen në pyetjet shumë interesante dhe me peshë që ua shtruan fëmijët- mysafirë. Përndryshe, kjo është vizitë tashmë tradicionale vjetore e nxënësve të kësaj moshe Komunës së tyre.

Gjithashtu kryetari i Komunës së Tuzit, nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunim me "UNI –UNIVERSUM International College" i cili fuqizohet dhe menaxhohet nga Arizona State University, të cilin e përfaqësoi kryetari i bordit z. Suat Berisha. Me anë të këtij memorandumi krijohet partneritet për marrëveshje të përgjithshme me Komunën tonë. Falë këtij Memorandumi hapet një fushë dhe shumë e rëndësishme për të rinjtë tanë, studentë dhe nxënës nga Malësia për vazhdimin e shkollimit në këtë universitet si dhe për studime ndërkombëtare. Pastaj mundësia e shfrytëzimit të bursave për studime vendore dhe ndërkombëtare, bursave për studime në ASU, shkëmbim të studentëve me universitetet partnere nga programi Erasmus, si dhe aktivitete tjera kulturore dhe sportive. Mundësitë që ofron ky Memorandum bashkëpunimi do të jenë shumë interesante për të rinjtë tanë dhe për krijimin e një karriere të mirëfilltë akademike. Në procesin e nënshkrimit ishin prezentë edhe nënkryetarët e Komunës së Tuzit, Ivan Ivanaj dhe Fisnik Gjokaj.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore për promovimin e komunës sonë, kryetari i komunës nënshkroi kontratën për festivalin "Ritmi i Evropës" për fëmijë dhe të rinj (nga mosha 12 deri 21 vjeç). Fituesit e audicioneve do të përfaqësojnë komunën e Tuzit në nivel shtetëror me këngë përfaqësuese të një shteti tjetër nga Eurovizioni.

Kryetari i komunës nënshkroi memorandum bashkëpunimi me ministren e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit, Andjela Jaksic Stojanovic. Ky memorandum përqendrohet në renovimin e shkollës fillore "Bashkimi" në Skorrë. Sipas memorandumit, Komuna e Tuzit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit, dhe Bashkësia Lokale do të investojnë rreth 126,000 euro në këtë projekt. Ky investim do të përfshijë rregullimin e hapësirave shkollore, në mënyrë që nxënësit dhe stafi arsimor të kenë kushte optimale për realizimin e mësimin.

Hapja e bizneseve të reja në Komunën e Tuzit është një shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal, krijimin e vendeve të punës dhe fuqizimin e komunitetit për një të ardhme më të qëndrueshme. Së bashku me drejtorin gjeneral të kompanisë One, z. Branko Mitroviq, kryetari hapi qendrën e re të kësaj kompanie në Komunën e Tuzit. Kjo qendër e re përfaqëson një hap të rëndësishëm në krijimin e vendeve të reja të punës dhe shërbimeve që ajo ofron për qytetarët tonë.

Gjithashtu, kryetari mori pjesë në hapjen e biznesit të familja Camaj e cila ka investuar në hapjen e një pike moderne të karburantit, e cila përmbush standardet më të larta evropiane. Ky

investim do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve dhe të krijojë një ofertë në sektorin e biznesit në komunën e Tuzit.

Ndër shënimet e datave ndërkombëtare, në ditën ndërkombëtare të Romëve, kryetari i komunës priti në takim disa përfaqësues të këtij komuniteti që punojnë në SHPK Komunale. Qëllimi i komunës është ngritja e standardit të jetesës së të gjithë qytetarëve përmes zhvillimit të vazhdueshëm e gjithëpërfshirës dhe përkrahja e të gjithë qytetarëve të saj, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, racore apo ndonjë tjetër. Kjo gjë më së miri dëshmohet në faktin se deri tani jemi angazhuar për të ofruar mundësi të barabarta, duke ofruar edukim dhe mbrojtje sociale për të gjithë e pa dallim.

Me rastin e 6 prillit, kryetari i komunës së bashku me bashkpunëtor vendosi lule pranë bustit të Dedë Gjon Lulit në Bardhaj ku më pas aktiviteti vazhdoi në mbrëmje në ku u shënua festa e kryengritjes së Malësisë. Mbrëmja akademike u zhvillua në QKI “Malësia” me një program të veçantë. Fjalën e rastit e mbajti kryetari, po ashtu edhe 4 panelistë: Akademik Prof. Dr. Frashër Demaj (historian); Akademik Prof. Dr. Anton K. Berishaj (sociolog); Prof. Dr. Teki Kurti (historian) dhe Mark Junçaj, prof (historian). Përveç kësaj, ekspozita e fotografive të muzeut kombëtar “Marubi”- Shkodër, u bë theks i mbrëmjes, veçanërisht për fotografitë e Dedë Gjon Lulit.

Komuna e Tuzit i është bashkëngjitur thirrjes së Kryetares së Sarajevës z. Benamina Kariq për mbështetjen e Rezolutës së OKB-së e cila mbetet të votohet në Asamblenë e Përgjithshme mbi “Ditën Ndërkombëtare e Reflektimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit të Srebrenicës në 1995”.

Me rastin e 1 shtatorit - Ditës së komunës së Tuzit kryetari i komunës mirëpriti dhe përshëndeti të gjithë ata që na nderuan me praninë e tyre në ceremoninë e organizuar. Ishte një moment i veçantë për të prezantuar mbi arritjet tona të përbashkëta dhe për të ndarë vizionin për të ardhmen e komunës tonë. Komuna e Tuzit ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, zhvillimin e infrastrukturës dhe mbështetjen e iniciativave që rrisin cilësinë e jetës për të gjithë banorët. Puna jonë e përbashkët ka sjellë përmirësime konkrete në çdo sektor, dhe jemi të përkushtuar që të vazhdojmë këtë rrugë suksesi. Gjatë ceremonisë, çmimi i komunës u nda dy personaliteteve: Mr. Lukë Junçaj dhe Dr. Safedin Beqaj. Këto çmime u dhanë për kontributet e tyre të veçanta në komunitet.

Në kuadër të muajit të nëntorit dhe për të përkujtuar 80-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë, Ambasada e Shqipërisë në Mal të Zi organizoi një aktivitet të veçantë në komunën e Tuzit. Ky aktivitet përfshinte shfaqjen e një filmi dokumentar, ekspozitën e fotografive historike dhe një koleksion armësh të përdorura gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke sjellë në vëmendje sakrificat dhe heroizmin e luftëtarëve shqiptarë në betejën për çlirim. Në këtë ngjarje solemne, banda muzikore e ushtrisë luajti pjesë të muzikës ceremoniale, duke i dhënë aktivitetit një atmosferë të veçantë dhe emocionuese. Ekspozita dhe interpretimi i bandës muzikore u pritën me entuziazëm nga të pranishmit, duke shërbyer si një moment për të reflektuar mbi historinë dhe për të forcuar lidhjet kulturore dhe historike mes shqiptarëve.

Kryetari i komunës gjithashtu pati rastin të falënderoi të gjithë që ishin pjesë e inaugurimit të shtatores së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ky moment historik për komunën tonë dhe për trashëgiminë kulturore do të mbetet gjithmonë i gjallë në kujtesën tonë, si një simbol i bashkimit dhe identitetit tonë. Një falënderim i veçantë shkon për diasporën tonë të dashur, që asnjëherë nuk mungon në mbështetjen e çdo iniciative që forcon rrënjët dhe vlerat tona kombëtare. Përkushtimi dhe solidariteti juaj janë një shembull frymëzues për të gjithë ne dhe një forcë e pakrahasueshme për komunën tonë. Po ashtu, shprehi mirënjohje të thellë ndaj bashkëpunëtorëve, pa të cilët ky organizim model nuk do të ishte i mundur. Puna e palodhur, përkushtimi dhe përpjekjet e singërta na e dhanë këtë moment madhështor që do të na frymëzojë për shumë vite. Shtatorja e Gjergj Kastriotit nuk është thjesht një monument, por është një dëshmi e krenarisë sonë kombëtare dhe udhërrëfyes për brezat që do të vijnë.

Komuna e Tuzit shënoi Ditën e çlirimit të Tuzit. Me një ceremoni të organizuar tradicionalisht kujtuam sakrificat e atyre që luftuan për lirinë dhe na frymëzon për të ndërtuar një të ardhme më të

mirë. Një falënderim dhe respekt të veçantë Brigadës së 22 Sulmuese nga Shqipëria, e cila kontribuoi në çlirimin e Tuzit.

Në traditën për mbështetjen e më të mirëve, Komuna vazhdon edhe më fuqishëm të investojë, prandaj kryetari i Komunës së Tuzit, nënshkroi me studentët përfitues kontratat për bursat e Komunës. Shuma e përgjithshme e bursave të dhëna kapi vlerën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) EUR, dhe është bërë traditë e Komunës për vlerësimin e arritjeve të studentëve tanë më të mirë.

Pastaj u organizua ceremonia e ndarjes së çmimeve për nxënësit më të mirë në Komunën e Tuzit. Kjo ngjarje e veçantë mbledhi së bashku nxënësit më të mirë të komunës sonë, të cilëve u shpërndanë çmime për rezultatet e tyre të jashtëzakonshme. Janë shpërblyer 33 nxënës, me çka u vlerësua puna e palodhur dhe angazhimi i tyre në arsim. Kjo ngjarje paraqet një moment krenarie për komunën tonë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes dhe investimit në rinin tonë.

Komuna e Tuzit gjithashtu ka ndarë një fond prej 40,000 eurosh për të mbështetur afarizmin e grave, duke dëshmuar përkushtimin tonë për fuqizimin ekonomik dhe barazinë gjinore. Investimi në gratë është investim në një shoqëri më të fortë, më të barabartë dhe më të zhvilluar. Komuna e Tuzit do të vazhdojë të jetë partner i sigurt në mbështetjen e iniciativave që fuqizojnë gratë dhe përmirësojnë jetën në komunitetin tonë.

Kryetari gjithashtu themeloi Këshillin ekonomik të komunës së Tuzit i cili filloj me punë. Këshilli është organ ekspert dhe këshillimor për fushën e politikave ekonomike dhe zhvillimore të komunës, i cili monitoron dhe analizon gjendjen e ekonomisë, nxit iniciativa, propozon dhe ndërmerr aktivitete me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim dhe përmirësim të ekonomisë dhe zhvillimit të marrëdhënieve të dialogut privat-publik. Këshilli ka 11 anëtarë nga fusha të ndryshme ekonomike: bujqësi, hotelieri, tregti. Roli i këtij këshilli është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm biznesi.

Komuna e Tuzit veçon rëndësinë e mbështetjes së sportistëve të rinj dhe të talentuar. Kryetari i komunës së bashku me kryetarin e Kuvendit, Fadil Kajoshaj, dhe sekretaren për vetëqeverisje lokale, Marina Ujkaj, pritën në takim kampionin europian në Taekwondo, Zinedin Beqoviq. Gjatë këtij takimi, u diskutua për arritjet dhe sukseset e Beqoviq në sportin e Taekwondosë ku kryetari shprehu mirënjohjen dhe krenarinë për përfaqësimin dinjitoz që Beqoviq i ka bërë komunës së Tuzit në arenën ndërkombëtare. Ai theksoi se Komuna e Tuzit ka qenë gjithmonë mbështetëse e sportistëve që kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në fusha të ndryshme sportive, por edhe në aktivitete të tjera kulturore dhe shoqërore. Kryetari i komunës gjithashtu e falënderoi për përkushtimin dhe punën e palodhur që ai ka treguar, duke e cilësuar atë si një shembull të shkëlqyer për të rinjtë e tjerë. Ai shprehu bindjen se sukseset e Beqoviq do të shërbejnë si frymëzim për gjeneratat e ardhshme të sportistëve nga Tuzi.

Gjithashtu, kryetari nënshkroi kontratat për shpërndarjen e mjeteve financiare për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024. Totali i mjeteve financiare të ndara për këtë program ishte 36.000,00€. Ky bashkëfinancim është pjesë e një strategjie më të gjerë të Komunës së Tuzit për të mbështetur zhvillimin e sportit, duke krijuar mundësi për të rinjtë dhe për të inkurajuar një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktive.

Pastaj u nënshkruan kontratat për financimin e projekteve të organizatave joqeveritare. Me këto kontrata u siguruan gjithsej 30.000,00€ për financimin e projekteve dhe programeve të ndryshme të organizatave joqeveritare gjatë vitit 2024. Mjetet janë ndarë në bazë të një konkursi publik për ndarjen e fondeve, i cili ishte hapur në përputhje me buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2024.

Kryetari zyrtarisht hapi 'Pazarin e Verës' në komunën tonë, një ngjarje që synon të bashkojë dhe të argëtojë të gjithë qytetarët. Nata e parë e cila u titullua 'Mbrëmja e diasporës', ishte një dedikim i veçantë për bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Kjo mbrëmje ishte një shenjë falënderimi për lidhjen dhe kontributin e tyre të pandërprerë ndaj vendlindjes. Për 10 ditët në vijim, komuna e Tuzit kishte përgatitur një program të pasur me aktivitete kulturore dhe artistike, ku muzika

do të jetë në qendër të vëmendjes. Kurse në kuadër të manifestimit "Vera në Malësi," u mbajt aktiviteti "Old Timer Fest Malësia." Ky event, i cili ka fituar popullaritet vit pas viti, tërhoqi entuziastët e makinave të vjetra dhe klasike nga e gjithë zona dhe më gjerë. U shfaqën automjete historike, duke i dhënë një shije nostalgjie dhe elegancë rrugëve të komunës sonë. Aktiviteti jo vetëm që pasuroi programin kulturor të verës në Malësi, por gjithashtu nxiti qytetqarët të vizitojnë diçka që për herë të parë zhvillohet në komunën tonë.

Një ngjarje tjetër me një vlerë të madhe ishte edhe hapja e Panairit të Librit në Tuz! Kjo ngjarje e rëndësishme kulturore bashkoi dashamirësit e librit, duke promovuar vlerat e arsimit dhe kulturës në komunën tonë. Ne, si Komunë e Tuzit, jemi të përkushtuar të organizojmë aktivitete që frymëzojnë dhe përçojnë këto vlera të çmuara, duke mbështetur dhe zhvilluar kulturën tonë.

E një kënaqësi e veçantë për kryetarin e komunës të hap stadiumin e qytetit në komunën e Tuzit, në prani të zëvendëskryeministrit Nik Gjelosaj, kryetarit të Federatës së Futbollit të Malit të Zi, Dejan Saviqeviq, dhe kryetarit të KF Deçiq, Pal Dreshaj. Hapja e stadiumit të qytetit në komunën e Tuzit shënon një moment historik për sportin lokal, duke ofruar një hapësirë moderne për zhvillimin e futbollit dhe aktiviteteve të tjera sportive. Ky investim do të ndikojë pozitivisht në rritjen e interesit të rinjve për sportin dhe do të ndihmojë në promovimin e vlerave të bashkëpunimit dhe garës së ndershme.

Kryetari i komunës, së bashku me fëmijët, ndezi dritat e bredhit të festave në sheshin Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Tuz. Me shumë krenari shpallën të hapur Pazarin e Dimrit në Komunën tonë, një ngjarje që tashmë është kthyer në një traditë të dashur dhe një simbol i atmosferës festive.

Nuk mund të lejmë pa futur në Raport edhe furnizimin me ujë që bën shërbimin në fjalë në zonat rurale të Malësisë, duke u vënë në shërbim të qytetarëve 24 orë.

Zyrtaret e prokurimit publik kryejnë detyra që kanë të bëjnë me planifikimin e prokurimit publik të mallrave, punëve dhe shërbimeve, zbatimin e procedurave në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, përgatitjen e planeve mujore dhe vjetore të prokurimit publik, përgatitjen e raporteve të prokurimit publik për organin kompetent shtetëror të prokurimit publik, si dhe detyra të tjera brenda fushëveprimit të përshkrimit të punës.

Çështjet e prokurimit publik në Komunën e Tuzit kryhen nga dy zyrtare të prokurimit publik të caktuar në Shërbimin e Kryetarit të Komunës së Tuzit.

Duke qenë se zhvillimi profesional është një nga format më të rëndësishme të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të pjesëmarrësve në sistemin e prokurimit publik, personat që kryejnë prokurimin publik pranë Kërkuesit - Kontraktues të Komunës së Tuzit kanë ndjekur disa trajnime të organizuara nga Drejtoria për Politika të Prokurimit Publik dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Plani është ndryshuar 7 (shtatë) herë gjatë vitit 2024 dhe ndryshimi i fundit ka qenë më 09.10.2024.

Llojet e procedurave të prokurimit publik (vlera pa TVSH)	
Procedurat e hapura	Prokurime të thjeshta (publikuar nëpërmjet SEPP)
3,039,168,88 € pa TVSH	243.019,68 € pa TVSH

Komuna e Tuzit ka zhvilluar disa procedura të hapura të prokurimit publik, përkatësisht:

1.	1. Projekti Zhvillimi i Tregut në Tuz - Vlera e kontraktuar pa TVSH 23,200.00€, Ofruesi i Shërbimit: “Civil Engineer” SHPK ;
2.	2. Prokurimi i autobusëve për transport urban – vlera e kontraktuar pa TVSH 57,851,24€, Ofruesi i Shërbimit “Winner company” SHPK;
3.	Derivate të naftës – vlera e kontraktuar pa TVSH 41.322,31 €, “Ofruesi i Shërbimit” Petrol Comerc” SHPK;
4.	Shërbime Televizive në gjuhën shqipe – vlera e kontraktuar pa tvsh 41.322,31 €, Ofruesi i Shërbimit “Boin” shpk;
5.	Ndërtimi i infrastrukturës lokale – vlera e kontraktuar pa tvsh 2.288.603,00 €, Ofruesi i Shërbimeve “Putevi Bar” shpk;
6.	Ndryshime dhe plotësime në dokumentacionin e projekteve ((Harmonizimi i dokumentacionit të projektit me Eurokodet) <i>1.(Ndryshimi i projektit kryesor për rindërtimin e aksit të rrugës PG – Tuz nga Ura Zharnicës në lumin Cem deri në kthesë për Shipshanik)</i> <i>2.(Ndryshimi i Projektit Kryesor për Rindërtimin e Urës së Zharnicës në lumin Cem në trasenë e rrugës rajonale PG-Tuz)</i> <i>3.(Ndryshimi i projektit kryesor të rikonstruksionit të udhëkryqit Bozhaj- Gollubovc në Tuz)</i> <i>4.(Ndryshimi i projektit kryesor për rregullimin e shtratit të lumit Urrela nga burimi i Milesbit deri në vendbanimin Vuksanlekaj) - Vlera e kontraktuar pa TVSH 4.780,00 EUR; 7.400,00 EUR; 6.200,00 EUR; 7.200,00 EUR – Ofruesi i Shërbimeve “Civil Engineer” shpk;</i>
7.	7. Përgatitja e Projektit Kryesor për rikonstruksionin e rrugës Tuz – Mataguzh, me vlerë të kontraktuar pa TVSH 40.350,00 €, Ofruesi i Shërbimeve “Civil Engineer” shpk;
8.	Vera në Malësi, (Panairi i Librit) (Kampi për fëmijë) (Mbrëmje e muzikës klasike) (Java e Filmit) ("Old timer feast Malesia") (Dita Ndërkombëtare e fëmijës) vlera e kontraktuar pa tvsh 16.505,00 EUR; 3.295,00 EUR; 3.290,00 EUR; 3.290,00 EUR; 7.850,00 EUR; 2.475,00 EUR – Ofruesi i Shërbimeve “Monte Sound” shpk;
9.	Ndryshimi dhe plotësimi i dokumentacionit projektues (Harmonizimi i dokumentacionit të projektit me Eurokodet - Procedura e përsëritur për Partinë V, VI i VI) (Rishikimi i Projektit Kryesor të ndryshuar për rindërtimin e aksit të rrugës PG-Tuz nga ura e Zharnicës në lumin Cem deri në kthesën për Shipshanik.) (Rishikimi i Projektit Kryesor të ndryshuar për rindërtimin e udhëkryqit Bozhaj - Gollubovc) vlera e kontraktuar pa TVSH,3.750,00 EUR 2.785,00 EUR 2.850,00 EUR- Ofruesi i Shërbimeve “Geotechnics Projects & Consulting” shpk;
10.	Përshtatja dhe rehabilitimi i infrastrukturës lokale, me vlerë të kontraktuar pa TVSH 227.753,20 €, Ofruesi i Shërbimeve “Koja company” shpk;
11.	11. Pazari veror - (Programi muzikor) (Shërbimet e prodhimit, brendimi dhe fotografimi) (Prokurimi i dekorimeve dhe dekorimit) (Përshtatja dhe transporti i shtëpive ekzistuese), vlera e kontraktuar pa TVSH, 24.650,00 EUR 2.150,00 EUR 2.140,00 EUR 2.050,00 EUR – Ofruesi i Shërbimeve “Magic Star Mne” shpk;
12.	Pazari Veror - Partia I. Shërbimet e zbatimit teknik (Procedura e përsëritur) vlera e kontraktuar pa TVSH. 8.491,00 EUR – Ofruesi i Shërbimeve “Monte Sound” shpk;
13.	Pazari i Dimrit në Malësi - (Programi muzikor) (Shërbimet për zhvillimin e udhëzimeve dhe projektimit konceptual) (Riparimi dhe transporti i shtëpive ekzistuese) (Pazari i Vitit

të Ri për fëmijë) me vlerë të kontraktuar pa TVSH, 22.660,00 EUR 2.560,00 EUR 1.650,00 EUR 3.570,00 EUR- Ofruesi i Shërbimeve “Magic Star Mne” shpk;
14. Pazari Dimëror në Malësi sipas Partive: Partia I, II dhe III (Procedurë e përsëritur) - (Shërbimet e zbatimit teknik) (Piroteknikë) vlera e kontraktuar pa TVSH. 13.980,00 EUR 1.610,00 EUR – Ofruesi i Shërbimeve “Monte Sound” shpk;
15. Prokurimi i fadromës, vlera e kontraktuar pa tvsh 87.000,00 €, Ofruesi i Shërbimeve “Eco Vladex” shpk;
16. Prokurimi i kazanave, vlera e kontraktuar pa tvsh 42.339,90 €, Ofruesi i Shërbimeve “Tekom Promet” shpk;
17. Pazari dimëror në Malësi - Partia V - Prokurimi i dekoreve për Vitin e Ri, dekorimi dhe montimi (Procedurë e përsëritur), vlera e kontraktuar pa tvsh 24.245,92 €, Ofruesi i Shërbimeve “Znak” shpk;
18. Pazari i dimrit në Malësi – Partia III Shërbime të sigurimit fizik (Procedurë e përsëritur), vlera e kontraktuar pa tvsh 8.000,00 € – Ofruesi i Shërbimeve “Security Guard Montenegro” shpk;

Procedurat që janë zbatuar si prokurim i thjeshtë kanë të bëjnë si më poshtë:

Lënda e prokurimit	Vlera e kontraktuar pa tvsh	Ofertuesi
Rishikimi i projektit të Tregut në Tuz	3.560,00 EUR	“Instituti për Zhvillim dhe Kërkim në Fushën e Sigurisë në Punë”
Reprezentacionidhe shpënzimet në bufe	10.743,80 EUR	“Tenegro group” shpk
Shërbimet e sigurimit fizik dhe teknik për persona dhe pronë të komunës së Tuzit	12.960,00 EUR	“Security Guard Monetenegro” shpk
Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softuerit sipas grupit	13.140,50 EUR	“B-one” shpk
Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softuerit sipas grupeve (Grupi II, III dhe IV)	660,00 EUR 660,00 EUR 4.120,00 EUR	“S2B” shpk
Vendosja e gardheve mbrojtëse përgjatë rrugëve lokale	14.627,50 EUR	“Korita sig” shpk
Rishikimi i Projektit Kryesor	4.800,00 EUR	“Geotechnics, Projects & Consulting”shpk
rikonstruksioni i rrugës Tuz - Mataguzh	3.200,00 EUR	“Geotechnics, Projects & Consulting”shpk
Prokurimi i stolave solare	8.397,00 EUR	“Vigoris Ecotech” shpk

Mirëmbajtja aktuale e pajisjeve - automjeteve	12.396,69 EUR	“Castellana Co” shpk
Dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim	10.281,20 EUR	“Institut za javno zdravlje”
Përgatitja e Projektit Kryesor për rindërtimin e rrugës Tuz - Hot	14.990,00 EUR	“BMR Baošić” shpk
Materiale për Zyra dhe pajisje të tjera administrative	164,99 EUR	“Merkator International” shpk
Rishikimi i Projektit Kryesor për rikonstruksionin e aksit Tuz - Bozhaj nga farmacia bujqësore deri në kthesën për Sukuruq	3.818,00 EUR	“Institut për Zhvillim dhe Kërkim në Fushën e Sigurisë në Punë”
Rishikimi i Projektit Kryesor për rikonstruksionin e rrugës nga Gjimnazi në rrugën lokale Dushiq - Vuksanlekaj	2.545,00 EUR	“Institut për Zhvillim dhe Kërkim në Fushën e Sigurisë në Punë”
Rishikimi i Projektimit të Rrugës Kryesore	2.220,00 EUR	“Institut për Zhvillim dhe Kërkim në Fushën e Sigurisë në Punë”
Përgatitja e Projektit Kryesor të Rrugës Pranë Plantacioneve Dushq - Vuksanlekaj	7.770,00 EUR	“Mbikëqyrja e ndërtimit dhe testimi laboratorik”SHA
"Docek"/"Pritja" Artan Korenica	5.785,00 EUR	“AFA” shpk
Përgatitja e Projektit Kryesor për rindërtimin e aksit Tuz - Bozhaj nga farmacia bujqësore deri në udhëkryqin për Sukuruq	9.900,00 EUR	“Optimusproject” shpk
Përgatitja e Projektit Kryesor për rikonstruksionin e rrugës nga Gjimnazi në rrugën lokale Dushiq - Vuksanlekaj	10.099,00 EUR	“Optimusproject” shpk
Kryerja e punimeve për montimin e peshoreve të kamionit	12.097,26 EUR	“Gradnja doo all Construction” shpk

Prokurimi i stolave dhe rrethojave mbrojtëse (Procedurë e përsëritur)	5.304,00 EUR	“Tuzmont Construction” shpk	
Blerja e pajisjeve të këndit të lojërave	4.822,00 EUR	“Deco group” shpk	
Shërbimet për organizimin e manifestimit të Ditës së Komunës	(Shërbimet e zbatimit teknik) (Shërbimet krijuese) (Shërbimet e marrjes me qira të pajisjeve) (Stafi) (Shërbimet e kateringut)	4.490,00 EUR 675,00 EUR 760,00 EUR 3.590,00 EUR 1.190,00 EUR	“Monte Sound” shpk
Shërbimet e mbikëqyrjes profesionale	6.760,00 EUR	“Marting Project” shpk	
Prokurimi i mobiljeve për zyrë	3.206,40 EUR	“Dr trade” shpk	
Prokurimi i kompjuterëve dhe pajisjeve kompjuterike	2.441,90 EUR	“G-tech” shpk	
Zhvillimi i softuerit për sektorët e hoteljerisë, zejtarisë dhe tregtisë	5.485,00 EUR	“DataLink” shpk	
Ndërtimi i pedestalit për monumentin e Skënderbeut	20.650,00 EUR	“MK-Ing” shpk	
Ceremonia e vendosjes së monumentit të Skënderbeut	679,44 EUR	“Brain Media”shpk	
Ceremonia e vendosjes së monumentit të Skënderbeut	(Shërbimet e zbatimit teknik) (Shërbimet e marrjes me qira të pajisjeve) (Stafi) (Akomodimi, pije dhe shërbime ushqimore)	1.710,00 EUR 4.620,00 EUR 6.680,00 EUR 1.020,00 EUR	“Magic Star Mne” shpk

Komuna e Tuzit gjatë vitit 2024 ka realizuar edhe prokurime të tjera të thjeshta të mallrave, shërbimeve dhe punëve duke përzgjedhur drejtpërdrejt subjektin e prokurimit nga një ofertues specifik me pranimin e pro-faturës, faturës fiskale ose kontratës, varësisht nga lloji i subjektit të prokurimit, në vlerë totale prej 245,260,20 euro me TVSH.

Bashkëpunimi me Shoqatat e Diasporës

Gjatë vitit 2024, përmes këshilltarit për diasporë, janë realizuar takime me përfaqësuesit e shoqatave të diasporës në SHBA, duke përfshirë:

Shoqatën “Malësia e Madhe” në New York dhe Michigan, Shoqatën “Jehona e Malësisë”, Shoqatën “Malësia” nga Kalifornia.

Këto takime kishin për qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin e aktiviteteve në mbështetje të komunitetit tonë në diasporë.

Mbështetja për Studentët

Zyra jonë, si edhe viteve të tjera, edhe këtë vit ka bërë informimin e studentëve në lidhje me bursat e ofruara nga shoqatat e diasporës, specifikuat nga:

Shoqata “Malësia e Madhe” në New York,

Shoqata “Malësia e Madhe” në Michigan.

Pas pranimit të dokumentacionit, aplikimet janë dorëzuar në adresat relevante të shoqatave, të cilat më pas kanë ndarë bursat për studentët fitues.

Kontributi për Redaksinë e TVMZ në Gjuhën Shqipe

Në bashkëpunim me Shoqatën “Malësia e Madhe” në New York, zyra ka ndërmjetësuar dhe realizuar dorëzimin e fondeve për blerjen e një droni si donacion për Redaksinë e TVMZ në gjuhën shqipe.

Organizimi i Takimeve me Mërgimtarët

Në koordinim me Sekretariatën për Vetëqeverisje Lokale, tash e pesë vite me radhë është organizuar një mbrëmje takimi me mërgimtarët në Sheshin “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”. Ky aktivitet ka shërbyer si një mundësi e rëndësishme për të diskutuar çështjet e diasporës dhe për të forcuar lidhjet me vendlindjen.

Përmendorja e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në Tuz

Një ndër projektet kryesore të realizuara këtë vit ka qenë vendosja e Përmendores së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në Tuz. Ky projekt ka shënuar përmbushjen e një nisme të kamotshme të diasporës dhe qytetarëve të Malësisë, duke pasur një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore.

Asistenca për Pajisjen me Dokumente

Zyra ka ofruar asistencë të vazhdueshme për qytetarët e diasporës lidhur me:

Pajisjen me pasaporta dhe letërnjoftime,

Regjistrimin në Librin Amëz,

Fillimin e procedurave për marrjen e shtetësisë.

Themelimi i Sekretariatit për Bashkëpunim me Diasporën

Në vitin 2024, pritet që Sekretariati për Bashkëpunim me Diasporën të fillojë funksionimin de jure dhe de facto, pas miratimit nga kryetari i Komunës dhe votimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit. Ky sekretariat do të rrisë efektivitetin e bashkëpunimit me diasporën, duke krijuar mundësi më të mëdha për realizimin e projekteve dhe iniciativave në të mirë të komunitetit.

Angazhimi i Zyrës për Diasporë gjatë vitit 2024 ka qenë maksimal, duke synuar forcimin e lidhjeve me institucioneve vendore dhe komunitetit tonë në diasporë. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me shoqatat dhe përfaqësuesit e mërgatës, janë realizuar projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në arsim, kulturë dhe administratë, duke përfunduar rolin e diasporës në zhvillimin e Malësisë.

2. SHËRBIMI I KRYEADMINISTRATORIT

Po ju dorëzoj raportin e punës së Shërbimit të Kryeadministratorit për vitin 2024 në bazë të dispozitave të nenit 77, paragrafit 1, paragrafit 6, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22), nenit 118, paragrafit 1, alineja 6, të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 24/19, 05/20, 51/22,

55/22) dhe nenit 11 të Udhëzimit për përgatitjen e Programit Vjetor të Punës dhe Raportit të punës dhe zbatimit të funksionit të vetëqeverisjes lokale.

Detyrën e Kryeadministratorit e kryej që nga data 17 tetori i vitit 2022 (e në vazhdim).

Në shërbim është i punësuar Anton Lulgjuraj, Këshilltar i Pavarur II - për zhvillimin e procedimit administrativ në shkallë të dytë.

Pasqyrë e procedurave administrative të shkallës së dytë (vendim administrativ)

Gjatë vitit raportues janë paraqitur gjithsej 65 ankesa, nga të cilat:

- 7 janë miratuar brenda afatit ligjor, në bazë të aktvendimit të Gjykatës Administrative;
- 13 janë miratuar brenda afatit ligjor për arsye të ndryshme;
- Janë refuzuar 49 ankesa brenda afatit ligjor (45 ditë);
- Ka vendosur sipas ankesës së Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacion (1);
- Ankesa për shkak të heshtjes së administratës, organi i shkallës së parë nuk ka vepruar (36);
- Në dy raste ankesa është tërhequr (2);
- Asnjë rast nuk është bartur në vitin 2025.

Procedura administrative e shkallës së parë në kompetencë të Zyrës së Kryeadministratorit

Në periudhën raportuese nuk ka pasur kërkesa për zgjidhje në procedurë administrative.

Detyra të tjera

- Propozim për mjete buxhetore për vitin 2025;
- Drafti i Planit kadrovik për vitin 2025, i cili i është dorëzuar për miratim Sekretariatit për Financa;
- Është sjellë Programi Vjetor i Punës së Shërbimit të Kryeadministratorit për vitin 2025;
- Në katër raste janë dhënë përgjigje në padi, me kërkesë të Gjykatës Administrative të Malit të Zi;
- Kam marrë pjesë në takimin e punës së kryeadministratorëve në Ulqin dhe Hrceg Novi;
- Kam marrë pjesë në ekipin punues për hartimin e Projektligjit për Tokën Bujqësore;
- Kam marrë pjesë në një takim pune pranë Unionit të Komunave;
- Kam vendosur në bazë të Kërkesës për Qasje të Lirë në Informacion;
- Kam dorëzuar dosjet e lëndëve në Gjykatën Ekonomike dhe në Gjykatën Administrative;
- Është dhënë mendim në Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Organizimin dhe mënyrën e Punës së Administratës Lokale të Komunës së Tuzit;
- Është hartuar dhe publikuar Udhëzuesi për Qasje të Lirë në Informacion;
- I është përgjigjur Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me pretendimet për heshtje nga administrata;
- Raporti i pagesave të mediave i është dorëzuar Ministrisë së Kulturës;
- Është përgaditur dhe dorëzuar Raporti për zgjidhjen e çështjeve administrative të MAP-s;
- Është mbajtur komunikimi i përditshëm me eprorët e organeve
- Kam marrë pjesë në miratimin e Procedurës për veprimtarinë e zyrës dhe përmirësimin e punës së arkivës;

- Janë kryer edhe punë të tjera administrative dhe teknike për nevojat e Shërbimit.

Konkludimi dhe masat e propozuara

Vëmendje e veçantë duhet kushtuar gjatë dorëzimit të ankesave tek ankuesi përmes organit të shkallës së parë, veçanërisht kur bëhet fjalë për dorëzimin. Nga komunikimi me organet e administratës lokale, kam vënë re se ka nevojë për fuqizimin e tyre me staf në profesione të veçanta.

Është e nevojshme që çdo organ të ketë një zyrtar të autorizuar për zhvillimin e procedurës në shkallë të parë.

IV. SHËRBIMET E VEÇANTA

1. SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT KOMUNAL

Për periudhën në vitin 2024, kemi forcuar veçanërisht mbikëqyrjen inspektuese për të kontrolluar orarin e punës së objekteve hotelierike, pastaj kemi forcuar mbikëqyrjen mbi shitjet jashtë tregut dhe kemi arritur rezultate të mira. Policia komunale dhe inspektionit komunal brenda vitit 2024, ka reduktuar ndjeshëm numrin e veturave të parkuara jashtë rregullores, në rrugët e komunës së Tuzit.

Struktura e kualifikimit të të punësuarve: VSS/PLP (5) dhe SSS/PMP (10)

- Numri i inspektimeve të kryera sipas kërkesave të qytetarëve: 106
- Numri i inspektimeve të kryera sipas detyrës zyrtare: 37
- Numri i procesverbaleve : 106
- Numri i vendimeve të marra: 19
- Numri i vendimeve për përmbarrim administrativ: 11
- Numri i përmbarrimeve administrative të kryera me detyrim të drejtpërdrejtë: 0
- Numri i njoftimeve të dërguara: 1006
- Numri i thirrjeve të bëra: 12
- Numri i urdhërave të lëshuar për kundërvajtje: 244
- Numri i raporteve të paraqitura për nënçmimin e zyrtarëve: 0
- Numri i vendimeve përmbarrimore: 0

Inspektorët komunalë i kushtuan vëmendje të veçantë kontrollit të vendimeve për orarin e punës;

Gjatë periudhës së sipërpërmendur janë intensifikuar aktivitetet për parandalimin e shitjes jashtë tregut të produkteve bujqësore pranë dhe në hyrje të tregut dhe në hapësira të tjera publike. Masat dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët komunalë kanë frenuar ndjeshëm shitjet jashtë pikave të shitjes me pakicë në publik dhe zona të tjera.

Kontrolli i orarit të punës së objekteve hotelierike në orët e hershme të mëngjesit, në ditët e javës dhe në fundjavë;

Numri i njoftimeve të dërguara, 1006, i referohet faktit se janë lënë 1006 njoftime në makina me shkelje, për marrjen e urdhrit të kundërvajtjes, si dhe dërgimin e njoftimeve me postë edhe për marrjen e urdhrit të shkeljes;

Përfshirja e inspektorëve në pjesën që lidhet me tregun e gjelbër, si dhe largimi i disa personave që merreshin me shitje jashtë tregut;

Janë sjell 19 vendime për masa, veprime dhe afate për eliminimin e parregullsive, të cilat nuk janë ankimuar, një njoftim për përmbarrim administrativ të aktvendimit përmbarrimor është lëshuar dhe është ekzekutuar me forcë;

Natyra e punës së Shërbimit të Policisë Komunale dhe Inspektionit Komunal kërkon bashkëpunim të ndërsjellë me Drejtorinë e Policisë dhe inspektime të tjera me qëllim krijimin e kushteve për masa cilësore për parandalimin dhe përhapjen e infeksionit të korona virusit të ri, si dhe mbrojtjen e popullatës nga kjo sëmundje infektive.

V. KONKLUDIM

Fokusi i administratës lokale edhe gjatë vitit 2024 vazhdoi të ishte sigurimi i punës me bazë ligjore duke zbatuar metoda bashkëkohore me qëllim që puna dhe shërbimi ndaj vendit dhe qytetarëve të jetë sa më cilësor. Kontrolli i vazhdueshëm që punonjësit e Komunës të punojnë në mënyrë sa më korrekte dhe me përgjegjësi, që të ushtrojnë profesionin e tyre në mënyrë efikase, por edhe të përmbushin detyrimet e tyre ndaj institucionit dhe qytetarëve. Në anë tjetër skuadrat e organeve të Komunës për një kohë të shkurtër kanë hartuar plane, përmes të cilave sigurohet integriteti, mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara dhe promovimi i barazisë gjinore.

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur thirrje publike për hartimin e Programeve të ndryshme, pjesëmarrje në gara, konkurse publike të fushave të ndryshme, bursave, paraqitje të propozimeve për ndarje të çmimeve të komunës, pjesëmarrje në panaire, njoftime dhe thirrje për ndërmarrësit dhe shoqëritë afariste nga komuna e Tuzit të cilët merren me veprimtari të ndryshme artizanale; persona që merren me oferta dhe prodhimtari gastronomike e plot aktivitete të tjera të cilat i japin gjallëri vendit e në të njëjtën kohë edhe ndihmojnë në zhvillimin e tij.

Ky raport përmbledh një sërë takimesh dhe iniciativash të rëndësishme të ndërmarra nga Komuna e Tuzit në fusha të ndryshme, duke përfshirë kulturën, turizmin, investimet, infrastrukturën dhe bashkëpunimin me diasporën. Komuna e Tuzit po vazhdon të investojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ndriçimin publik dhe rritjen e hapësirave të gjelbra. Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, u ndërtuan disa parqe të vogla urbane, ndërsa po punohet edhe për zgjerimin e rrugëve në zonat rurale. Në kuadër të përpjekjeve për të zhvilluar ekonominë vendore, komuna ka ndarë fonde për mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Komuna ka inauguruar disa projekte të rëndësishme infrastrukturore, si rrugë të reja, vendosjen e stolave diellorë për qytetarët, dhe investime në rrjetin e ujësjellësit. Po ashtu, po bëhen përpjekje për të përmirësuar sinjalistikën rrugore dhe sigurinë e këmbësorëve, veçanërisht pranë institucioneve arsimore.

Kur është në pyetje përmirësimi i infrastrukturës rrugore u inaugurua ndërtimi i aksit rrugor pranë Gjimnazit. Projekti përfshin gjithashtu ndërtimin e 72 vendeve të parkimit dhe ka një vlerë totale prej 411.369,96€. Kryetari me këtë rast theksoi se Komuna e Tuzit vazhdon të investojë në infrastrukturën rrugore në çdo zonë të komunës. Këto investime kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë banorët, duke rritur sigurinë në rrugët e komunës. Ky projekt është një tjetër dëshmi e angazhimit të komunës për të zhvilluar dhe modernizuar rrjetin rrugor, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetesës dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik të zonës.

Pastaj u përurua ujësjellësi nga vendi Qaf Kishë - Drume deri në Bardhaj të Hotit, një projekt jetik për banorët e kësaj zone, me vlerë 638.414,57 euro. Ky investim synon të zgjidhë problematikat afatgjata të furnizimit me ujë të pijshëm, duke përmirësuar kushtet bazë të jetesës për qytetarët dhe garantuar një furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm.

Kryetari i komunës, bashkë me nënkryetarët Ivan Ivanaj dhe Fisnik Gjokaj, patën kënaqësinë të përurorin një projekt të rëndësishëm në vendbanimin Kojë. Rruga e re përmirëson infrastrukturën lokale, duke ofruar lehtësi të mëdha për lëvizjen dhe lidhjen mes banorëve të zonës, por edhe të gjithë Malësisë! Ky investim synon të përmirësojë jetën e përditshme të banorëve dhe të hapë mundësi për zhvillim ekonomik, social dhe kulturor në të ardhmen. Rruga e re simbolizon përkushtimin tonë për të ndërtuar një Malësi që ka vëmendjen dhe mbështetjen që meriton!

Komuna e Tuzit ka nisur punën për vendosjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale në të gjitha rrugët e qytetit. Përmirësimi i sinjalistikës rrugore ka për qëllim jo vetëm rritjen e sigurisë në rrugë por edhe krijimin e hapësirave për parkim si dhe të lehtësojë lëvizjen e këmbësorëve. U vendos rrethoja në trotuar pranë rrugës kryesore përballë kopshtit, shkollës fillore dhe shkollës së mesme. Ky

projekt është shembull i përkushtimit të komunës për krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët. Gjithashtu u punua në regullimin e sinjalistikës horizontale në parkingun afër QIK Malësia dhe Shtëpisë së Shëndetit. Këto punime përfshijnë shenjëzimin e vijave dhe hapësirave të parkimit, për të përmirësuar sigurinë dhe organizimin e trafikut në atë zonë. Kjo iniciativë pritet të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të hapësirës së parkimit për qytetarët. Vijon vendosja e sinjalistikës rrugore me tregues shpejtësie në rrugën kryesore pranë institucioneve shkollore. Vendosja e kësaj sinjalistike përbën një masë të rëndësishme për përmirësimin e sigurisë së fëmijëve dhe të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Kjo nismë synon të reduktojë rrezikun e aksidenteve rrugore në zonat pranë institucioneve shkollore.

Kur është në pyetje përmirësimi i infrastrukturës rrugore, ndërmarrja komunale “Komunale Komunalno” bëri riparimin e gropave në rrugët lokale. Riparimi i gropave është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurisë rrugore në territorin e komunës së Tuzit. Ky është një hap pozitiv që tregon përkushtim për përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës. Gjithashtu, mbas të reshurave të dimrit të cilat kishin dëmtuar pjesën e rrugës në fshatin Kshevë, Komuna e Tuzit me shërbimet e saj SHPK “Komunale” ka bërë sanimin e kësaj rruge. Sanimi i rrugës së fshatit në Kshevë është një proces jetik i mirëmbajtjes së infrastrukturës që kryhet për të riparuar rrugën pasi një pjesë ishte dëmtuar nga shiu.

Komuna e Tuzit ka bërë asfaltimin e parkingjeve përreth stadiumit të Deçiqit. Asfaltimi i parkingjeve do të lehtësojë parkimin dhe do të kontribuojë në organizimin më të mirë të hapësirave publike gjatë ngjarjeve sportive dhe aktiviteteve të tjera që zhvillohen në stadium. Projekti është një nga disa iniciativa që synojnë të rrisin standardet e infrastrukturës në Komunën e Tuzit.

Në vendbanimin Dinoshë u përrua rruga e rikonstruktuar, pjesë e një projekti të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës lokale. Projekti përfshin ndërtimin e rrugës dhe asfaltimin e parkingjeve për xhaminë e fshatit dhe objektin e shërbimeve funerale. Vlera e projektit: 237,619.00 euro. Pastaj, është realizuar një projekt të rëndësishëm infrastrukturor në fshatin Dinoshë, duke asfaltuar jo vetëm rrugën kryesore të fshatit, por edhe parkingun e Qendrës Funerale, varrezave katolike dhe Xhamisë së fshatit. Ky zhvillim tregon përkushtimin e komunës për të përmirësuar kushtet e jetesës për banorët e Dinoshës.

Komuna e Tuzit ka realizuar një investim të rëndësishëm në infrastrukturën e shkollës fillore në Skorraq. Ky investim përfshin asfaltimin e fushës sportive dhe të parkingut të shkollës, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet për nxënësit dhe stafin e shkollës.

Më pas ka realizuar asfaltimin e aksit rrugor që lidh Sukruqin me Vranën. Ky projekt është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës lokale, duke lehtësuar qarkullimin e banorëve dhe automjeteve në këtë zonë.

Komuna e Tuzit gjithashtu ka realizuar punimet për ndërtimin e rrugës në vendbanimin Kshevë, e cila lidh këtë zonë me shkollën lokale. Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës dhe lehtësimin e qasjes për banorët, veçanërisht për nxënësit dhe prindërit që e përdorin këtë rrugë. Ndërtimi i saj është një hap i rëndësishëm në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e kësaj zone.

Ka përfunduar projekti ideor për shkollën në Dheun e Zi, një hap i rëndësishëm drejt realizimit të këtij projekti. Në parcelën prej 5.090 m², të cilën e ka blerë Komuna e Tuzit, është planifikuar ndërtimi i shkollës me sipërfaqe prej 3.693 m², që do të përmbajë të gjitha hapësirat e nevojshme për mësim modern.

Komuna e Tuzit ka përfunduar asfaltimin e rrugëve lokale në fshatrat e Trieshit, duke përmirësuar infrastrukturën dhe lehtësuar lëvizjen e banorëve. Ky projekt është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit ekonomik dhe turizmit lokal, duke e bërë zonën më tërheqëse për të gjithë njerzit që vizitojnë këtë vend. Gjithashtu është përfunduar asfaltimi i rrugës që lidh Trieshin me Grudën, një investim i rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës lokale. Projekti synon: lehtësimin e lëvizjes,

lidhjen më të mirë të fshatrave, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe turistik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët.

Është përfunduar rikonstrukcioni i aksit rrugor Dushiq - Vuksanlekaj- Rranx Qaf. Ky projekt synon të sjellë një përmirësim të madh në infrastrukturën e zonës, duke lehtësuar lëvizjen dhe rritur sigurinë për banorët dhe vizitorët. Segment jetik për lidhjen mes fshatrave, ky aks do të ofrojë një përvojë më cilësore dhe të sigurt për të gjithë ata që e përshkojnë. Puna përfshiu: zgjerimin dhe riparimin e rrugës, vendosjen e sinjalistikës së re dhe ndërtimin e një strukture moderne, që përmbush standardet më të larta për qarkullimin. Ky investim është pjesë e planeve afatgjata për zhvillimin e infrastrukturës në komunën e Tuzit dhe pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e zonës!

Përmes projekteve të mbështetura nga Eko-Fondi dhe institucionet ndërkombëtare, Komuna e Tuzit ka siguruar përmirësime në infrastrukturën e saj, si dhe në sektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Po ashtu, mbështetja për bujqësinë dhe përkrahja për pjesëmarrjen e prodhuesve lokalë në panaire tregon përkushtimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbështetje për bizneset lokale.

Në komunën tonë janë vendosur 20 kontejnerë nëntokësorë për katër lloje mbetjesh në pesë lokacione. Tani, komuna e Tuzit po fillon ndarjen e mbetjeve. Me këtë rast me instalimin e aplikacionit NERA-T u morën udhëzime të qarta mbi ndarjen e mbetjeve dhe të ndiqni të reja mbi konceptin “Zero Waste”. Kontejnerët dhe aplikacioni NERA-T janë pjesë e projektit NERA, i financuar nga BE-ja dhe bashkëfinancuar nga Komuna e Tuzit dhe Komuna e Pejës përmes programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë.

Pastaj, me realizimin e projektit “Tuzi i gjelbër” i cili bashkëfinancohet nga Eko Fondi, me vlerë rreth 30 mijë euro u gjelbërua pjesa e rrugës M4 në Tuz përmes të cilit u ndikua pozitivisht në peisazhin i komunës sonë. Gjithashtu me qëllim të mirëmbajtjes më efikase të sipërfaqeve të gjelbërta, në bashkëpunim me SHPK “Komunale” përmes burimeve të EKO fondit, siguroam një traktor të ri për pastrimin dhe kositjen e barit në rrugët lokale. Vlera totale e blerjes është 52,735,43 euro me TVSH, ndërsa subvencioni i fondit ECO është 34,000,00 euro.

Komuna e Tuzit poashtu ka realizuar me sukses projektin për blerjen e pajisjeve komunale në bashkëpunim me Eko Fondin! Falë granteve të Eko Fondit dhe kontributit të Komunës së Tuzit, është blerë një fadromë me vlerë totale 105,270.00 €! Granti i Eko Fondit: 64,800.00 € (61.56%). Pjesëmarrja e Komunës së Tuzit: 40,470.00 € (38.44%). Kjo fadromë do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetet e Ndërmarrjes Komunale “Komunalno-Komunale” sh.p.k. Tuzi, duke mundësuar heqjen më të shpejtë dhe efikase të deponive të egra dhe duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit tonë!

Gjithashtu u përfundua me sukses projekti për largimin e “mbetjeve të egra” në bashkëpunim me Eko-Fondin, duke krijuar një sistem për menaxhimin e mbetjeve dhe edukimin e popullatës për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve. Për të parandaluar grumbullimin e mbetjeve të reja, u vendosën dy zinxhirë prej 50 metrash, të cilët do të pastrohen nga sherbimimet komunale. Vlera e projektit ishte 41,391.13 euro, me një subvencion prej 27,366.03 euro.

Një pikë tjetër e realizimit është ajo që komuna e Tuzit, me mbështetjen e Eko Fondit, ka përfunduar me sukses projektin për furnizimin me kosha komunalë për mbledhjen selektive të mbeturinave, me një vlerë totale prej 51,231.28 EUR! Eko Fondi ka kontribuar me 39,432.72 EUR, ndërsa Komuna e Tuzit ka investuar 11,798.56 EUR. Këta kosha do t’u shpërndahen 535 familjeve, duke mundësuar ndarjen më efikase të mbeturinave dhe kontribuar në krijimin e një komune më të pastër dhe më të gjelbër! Me përkushtim, vijojmë për të krijuar një mjedis më të mirë për të gjithë!

Në kuadër të këtyre aktiviteteve u organizua edhe një vizitë edukative për 20 nxënës të shkollës fillore “Mahmut Lekiq” në qendrën e riciklimit të Deponija sh.p.k., në bashkëpunim me Komunën e Tuzit, Bordin Ekologjik të shkollës dhe “Komunalno-Komunale” sh.p.k. Tuzi. Gjatë vizitës, nxënësit u njohën me projektin “Qasje e re për revitalizimin e mjedisit – Nera” dhe me procesin e riciklimit të mbetjeve të mbledhura në shkollë dhe në amvisëri. Në qendrën e riciklimit, atyre iu shpjeguan hapat

e ripërdorimit të mbetjeve të ndara. Komuna e Tuzit mbështet iniciativa të tilla që forcojnë besimin në sistemin e riciklimit, duke besuar se brezi i ri luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e mjedisit.

Komuna e Tuzit ka subvencionuar fermerët për 832.05 hektarë me një investim prej 236,722.79 euro. Kjo mbështetje ndihmon 254 fermer në përmirësimin e prodhimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke lehtësuar barrën financiare të fermerëve. Ky investim tregon përkushtimin e komunës për të forcuar sektorin bujqësor, duke krijuar kushte më të mira për fermerët dhe duke nxitur një ekonomi lokale më të qëndrueshme.

Komuna e Tuzit mbështet prodhuesit bujqësorë për pjesëmarrjen në panairin “Najbolje iz Crne Gore” në qendrën tregtare Big Fashion. Në vitin raportues, katër prodhues dhe një artizan nga Tuzi prezantuan produktet e tyre. Komuna do të vazhdojë të mbështesë praktikën e mira të prodhimit dhe produkte cilësore.

Spërkatja e mushkonjave në komunën e Tuzit është një aktivitet që është realizuar në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të Malit të Zi, me qëllim të reduktimit të numrit të mushkonjave dhe mbrojtjes së shëndetit publik. Kjo ndërhyrje është pjesë e programit të kontrollit të insekteve, i cili synon përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit publik në komunë.

Komuna e Tuzit ka pastruar borën në rrugën drejt bjeshkës Korita, duke siguruar që kjo zonë të mbetet e kalueshme për banorët dhe vizitorët. Përkushtimi i komunës për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe lehtësimin e qarkullimit në zonat malore mbetet prioritet, duke garantuar siguri dhe akses të pandërprerë gjatë sezonit të dimrit.

Të gjitha këto projekte dhe iniciativa dëshmojnë përkushtimin e Komunës së Tuzit për të krijuar një mjedis më të zhvilluar, të sigurt dhe të favorshëm për banorët e saj. Përmes investimeve në infrastrukturë, arsim, ekonomi dhe bashkëpunim rajonal, synohet të rritet cilësia e jetës dhe të krijohen mundësi të reja për të gjithë qytetarët.

Në vitin 2024, Komuna e Tuzit ka bërë një progres të jashtëzakonshëm në përmirësimin e mjedisit, infrastrukturës, dhe shërbimeve për qytetarët. Projekti për ndarjen e mbetjeve dhe implementimi i kontejnerëve nëntokësorë janë hap i rëndësishëm në drejtim të një komune më të pastër dhe më të gjelbër. Po ashtu, mbështetja për fermerët dhe inkurajimi i prodhimit lokal janë investime që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të komunitetit. Aktivitetet kulturore dhe sportive, si hapja e stadiumit dhe zhvillimi i "Pazarit të Verës", kontribuojnë në forcimin e bashkësisë dhe promovimin e vlerave të kulturës dhe sporteve.

Në mbledhjen e fundit për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Tuzit, u miratua me shumicë votash buxheti për vitin 2025, me një vlerë prej 9,320,548.45 euro. Ky buxhet shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të komunës, duke përfshirë projekte strategjike që synojnë përmirësimin e infrastrukturës, fuqizimin ekonomik dhe rritjen e cilësisë së jetesës për të gjithë banorët, buxheti i cili përfshin projekte strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të komunës, është një hap i rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të mirë për qytetarët tanë. Me përkushtimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin e fortë me partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë, Komuna e Tuzit do të vazhdojë të sigurojë kushte më të mira për jetesën e banorëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit tonë.

Nr. 01-077/25-1477/1

Tuz, 14.03.2025

KRYETARI,
Lindon Gjellaj